

RAPORTI VJETOR 2016 ANNUAL REPORT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

RAPORTI VJETOR 2016 ANNUAL REPORT



PËRMBAJTJA / CONTENTS

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPM.....	9
<i>A WORD FROM THE GENERAL DIRECTOR OF THE GDPT</i>	
1. PRONËSIA INTELEKTUALE	12
1. <i>INTELLECTUAL PROPERTY</i>	
2. POLITIKAT AKTUALE PËR ZHVILLIMIN E PRONËSISË INDUSTRIALE NË SHQIPËRI.....	13
2. <i>CURRENT POLICIES FOR THE DEVELOPMENT OF INDUSTRIAL [NOTE THAT IN THE ACTUAL CAPTION, THEY USE THE WORD 'INTELLECTUAL'] PROPERTY IN ALBANIA</i>	
3. DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE	18
3. <i>GENERAL DIRECTORATE OF PATENTS AND MARKS</i>	
4. SHËRBIME TË REJA	20
4. <i>NEW SERVICES</i>	
5. PATENTAT E SHPIKJEVE DHE MODELET E PERDORIMIT	24
5. <i>PATENTS FOR INVENTIONS AND UTILITY MODELS</i>	
6. MARKAT TREGTARE.....	29
6. <i>TRADEMARKS</i>	
7. DISENJOT INDUSTRIALE	38
7. <i>INDUSTRIAL DESIGNS</i>	
8. TREGUESIT GJEOGRAFIKË	40
8. <i>GEOGRAPHIC INDICATORS</i>	
9. BORDI I APELIMIT	44
9. <i>BOARD OF APPEAL</i>	
10. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	48
10. <i>INFORMATION TECHNOLOGY</i>	
11. FINANCA.....	50
11. <i>FINANCE</i>	
12. AKTIVITETET	55
12. <i>ACTIVITIES</i>	
13. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE	64
13. <i>COOPERATION AND AGREEMENTS</i>	
14. PROMOVIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI	74
14. <i>PROMOTION AND RAISING AWARENESS</i>	
15. INTERVISTA.....	82
15. <i>INTERVIEWS</i>	
16. KONTAKTE.....	84
16. <i>CONTACTS</i>	



SHKURTIME / ABBREVIATIONS

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

General Directorate of Patents and Marks

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

World Intellectual Property Organisation

Pronësia Intelektuale

Intellectual Property

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes

Ministry of Economic Development, Tourism, Trade and Entrepreneurship.

Zyra Evropiane e Patentave dhe Markave

European Patent Office

Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale

European Union Intellectual Property Office

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësië Industriale

General Directorate of Industrial Property

DPPM

GDPT

OBPI

WIPO

PI

IP

MZHETTS

MEDTTE

ZEP

EPO

ZBEPI

EUIPO

DPPI¹

GDPI

¹ Me hyrjen në fuqi në datë 25.03.2017, të Ligjit nr. 17/2017, datë 16.02.2017 “Ligji 17/2017 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale,” të ndryshuar”, emërtimi Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është ndryshuar me emërtimin e ri Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

With entry into force on 25.03.2017, of Law no. 17/2017, date 16.02.2017 “Law 17/2017” On Some Additions and Amendments to Law no. 9947, dated 07.07.2008 “On Industrial Property”, as amended”, the title of the General Directorate of Patents and Trademarks has changed to General Directorate of Industrial Property



I nderuar lexues,

Viti 2016 ishte një ndër vitet më të suksesshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Ky sukses është rezultat i punës serioze dhe profesionale të drejtorisë sonë. Prioritet iu dha zbatimit të parimit bazë të administratës publike që është efienca dhe ofrimi i shërbimit sa më cilësor ndaj publikut.

Këtë vit Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave hyri në një fazë të re të aktivitetit të saj, të quajtur "REFORMIMI I SISTEMIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE NË SHQIPËRI".

Hapi më i rëndësishëm i kësaj reforme u konkretizua me miratimin e Strategjisë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020, e cila parashikon arritjen e standarteve të njëjta me ato të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri.

Strategjia parashikon dhe përmirësimin e bazës ligjore mbi Pronësinë Industriale. Për këtë arsye kam kënaqësinë të njoftoj që ky hap strategjik tashmë është konkretizuar me hartimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë Industriale", të ndryshuar", i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16 Shkurt 2017 dhe pritet të hyjë në fuqi me datë 25.03.2017.

Ky ligj do të mundësojë lehtësimin e procedurave të aplikimit për regjistrimin e patentave mbi shpikjet, modelevë të përdorimit, markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë. Afatet e regjistrimit do të shkurtohen ndjeshëm dhe do të rritet cilësia e ekzaminimit të objekteve të Pronësisë Industriale.

Tregu i kapitalit intelektual do të marrë jetë dhe do të kthehet në vlerë ekonomike të shtuar për mbajtësit e të drejtave. Parashikohet edhe përdorimi si kolateral i objekteve të regjistruara të Pronësisë Industriale. Asetet jofizike do të marrin vlerë monetare konkrete nëpërmjet shitblerjes së tyre, duke e bërë tregun shqiptar edhe më dinamik.

Gjithashtu ky projektligj, për herë të parë plotëson kuadrin ligjor të përshtatshëm për mbrojtjen dhe zhvillimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës në Shqipëri si dhe regjistrimin ndërkombëtar të tyre.

Këto objekte të rëndësishme të Pronësisë Industriale mbrojnë dhe u japin vlerë produkteve agrokulturore, ushqimore apo artizanale të cilat kanë karakteristika që burojnë nga kushtet klimaterike dhe traditat e zonës ku ato prodhohen. Duke qenë se Shqipëria



Dear Readers,

The year 2016 was one of the most successful years of the General Directorate of Patents and Marks. This success is a result of the serious and professional work of our directorate. Priority was given to implementation of the basic principle of the public administration, which is efficiency and provision of the highest quality of service to the public.

This year the General Directorate of Patents and Marks entered into a new phase of its activity, called "REFORMING THE SYSTEM OF INDUSTRIAL PROPERTY IN ALBANIA"

The most important step in this reform was made concrete with the approval of the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020, which foresees reaching standards that are the same as those of the European Union for the protection of Intellectual Property rights in Albania.

The Strategy also provides for the improvement of the legal basis on Industrial Property. For this reason, I am pleased to inform you that this strategic step has already been made concrete with the drafting of the law "On some amendments and additions to law no.9947 dated 7.7.2008, "On industrial property", amended, which was approved by the Assembly of Albania on 16 February 2017 and is expected to enter into force on 25.03.2017.

This law will facilitate the procedures of application for the registration of patents for inventions, utility models, trademarks, industrial designs and geographic indicators. The time periods for registration will be shortened significantly and the quality of the examination of Industrial Property objects will be raised.

The indicators of intellectual capital will take on life and turn into added economic value for the holders of rights. The use of objects of Industrial Property as collateral is also foreseen. Non-physical assets will assume concrete monetary value through being purchased and sold, making the Albanian market even more dynamic.

In addition, this law for the first time completes an appropriate legal framework for the protection and development of geographic indicators and designations of origin in Albania, as well their international registration.

Those important objects of Industrial Property protect and give value to agricultural or food products or handicrafts that have characteristics stemming from the climatic conditions and traditions of the area where they are produced. Albania is a country that thanks to its biodiversity, tradition and cultural inheritance has

është një vend i cili në sajë të biodiversitetit, traditës dhe trashëgimisë kulturore, ka potencial për të zhvilluar këto produkte specifike të cilat, konsiderohen si resurse të fuqishme ekonomike. Mbrojtja nga falsifikimi i këtyre produkteve krijon një treg të sigurt për prodhuesit vendas, si dhe cilësi të garantuar për konsumatorët. Identifikimi dhe regjistrimi i tyre do të nxisë rritjen ekonomike në zonat rurale, si dhe eksportin e produkteve shqiptare në tregun e huaj duke i bërë ato të mirënjohura në botë.

Ligji parashikon masa konkrete për zbatueshmërinë e tij. Kjo do të arrihet nëpërmjet rishtruktimit të institucionit përgjegjës për sistemin e Pronësisë Industriale në Shqipëri me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare të saj.

Gjithashtu me kënaqësi ju bëjmë me dije se këtë vit DPPM arriti të presë pranë zyrave të saj një numër rekord aplikimesh për regjistrimin e markave tregtare dhe patentave mbi shpikjet.

Për herë të parë që nga krijimi i DPPM, numri i aplikimeve për regjistrimin e markave tregtare arriti në shifrën rekord 1055, ndërsa numri i aplikimeve për patentimin e shpikjeve nga nënshetëtarë shqiptarë arriti në 27.

Rritja e këtyre aplikimeve është një tregues i qartë se në tregun shqiptar po shtohen produktet dhe shërbimet e reja dhe territori shqiptar po bëhet gjithnjë e më atraktiv për kompanitë e huaja të cilat shprehin interes për shtrirje të mbrojtjes së pronës industriale në Shqipëri.

Më poshtë po paraqes një përmbledhje me arritjet kryesore të DPPM gjatë vitit 2016.

- U shkurtua ndjeshëm afati i ekzaminimit të markave nëpërmjet ekzaminimit më të shpejtë dhe publikimit çdo muaj.
- U përmirësua cilësia e ekzaminimit të markave. Këtu theksojmë se filloi edhe ekzaminimi i markave nga Sistemi i Madridit të cilat nuk ishin ekzaminuar që prej nënshkrimit të marrëveshjes së Madridit në vitin 1995.
- Shërbimet elektronike u përmirësuan dhe rregjistrat on-line përditësohen çdo javë nga çdo muaj që ishte më parë.
- Përfundoi dixhitalizimi i arkivës së patentave, markave dhe disenjave industriale.
- Përfundoi klasifikimi i elementeve figurative të markave, që mundëson një shërbim më cilësor kërkimi.
- Përfundoi saktësimi i të dhënave të markave të sistemit të Madridit.
- Në të gjithë vendin u organizuan aktivitete promovuese për Pronësinë Industriale, duke zhvilluar konferenca dhe seminare me të ftuar nga të gjitha grupet e interesit.
- Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua Mbledhja e 10-të vjetore e vendeve anëtare të Zyrës Evropiane të Patentave, ku morën pjesë Presidenti i Zyrës Evropiane të Patentave dhe përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të organizatave dhe zyrave të Pronësisë Intelektuale të vendeve anëtare në këtë

potential to develop those specific products, which are considered a powerful economic resources. The protection of those products from falsification creates a secure market for local producers, as well as guaranteed quality for consumers. Their identification and registration will encourage economic growth in rural areas, as well as the export of Albanian products in the foreign market, making them well-known worldwide.

The law provides concrete measures for its implementation. This will be achieved through restructuring the institution responsible for the system of Industrial Property in Albania for the purpose of strengthening its administrative and financial capacities.

In addition, it is with pleasure that we make known to you that this year, the GDPT succeeded in receiving at its offices a record number of applications for the registration of trademarks and patents for inventions. For the first time since the creation of the GDPT, the number of applications for the registration of trademarks reached the record number of 1055, while the number of applications for patenting inventions by Albanian citizens reached 27.

The increase of those applications is a clear indication that new products and services are being added in the Albanian market, and Albanian territory is becoming more and more attractive for foreign companies, which are expressing interest in extending the protection of their industrial property to Albania.

Below I present a summary of the main achievements of the GDPT during 2016.

- The time period for examination of trademarks was considerably reduced through more rapid examination and publication every month.
- The quality of the examination of trademarks was improved. We stress here that the examination of marks by the Madrid System began, which had not been examined since the signature of the Madrid agreement in 1995.
- Electronic services were improved, and the on-lie registered are now updated weekly, compared to previous monthly updating.
- Digitalisation of the archive of patents, trademarks and industrial designs concluded.
- The classification of figurative elements of trademarks was concluded, which enables a qualitative searching service.
- Work concluded on making exact the data of trademarks of the Madrid system.
- Promotional activities were organised about Industrial Property in the entire country, with conferences and seminars being held to which all interest groups were invited.
- For the first time, the 10th Annual Meeting of the European Patent Office was held in Albania, in which the President of the European Patent Office took part as well as high level management representatives of the organisations and Intellectual Property Offices of EPO member countries. During

organizatë. Gjatë këtij eventi u organizuan takime të rëndësishme strategjike ndërmjet Presidentit të ZEP z. Benoit Battistelli dhe znj. Milva Ekonomi Ministre e MZHETTS dhe gjithashtu me znj. Milena Harito Ministre për Inovacionin dhe Administratën Publike.

- U arrit të ofrohen shërbime të reja elektronike që shtrijnë spektrin e marrjes së informacionit mbi objektet e Pronësisë Industriale edhe në sistemet e kërkimit ndërkombëtare si: TMview dhe DesignView të administruara nga ZBEPI mbi Pronësinë Intelektuale dhe u mundësua aksesimi në gjuhën shqipe në ESPACENET e administruar nga ZEP.
- DPPM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi teknik e Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, Zyrën Evropiane të Patentave, Zyrën e Bashkimit Evropian mbi Pronësinë Intelektuale dhe me zyrat homologe të Turqisë, Kinës, Polonisë dhe është në proces me vende të tjera.
- Janë lidhur memorandume bashkëpunimi me Unionin e Dhomave të Tregtisë, me universitetet “Luarasi” dhe “Metropolitan”.
- Janë zhvilluar disa leksione të hapura në universitetet shtetërore dhe private me qëllim nxitjen e brezave të rinj drejt inovacionit dhe ndërgjegjesimit të tyre mbi rëndësinë e të drejtave të Pronësisë Industriale.
- Janë kryer vizita tek biznesi, me qëllim ofrimin e këshillave dhe evidentimin e potencialit të këtyre bizneseve për zhvillimin dhe mbrojtjen e Pronësisë Industriale në përshtatje me nevojat dhe fushat e tyre të aktivitetit.
- Është rritur transparenca dhe është lehtësuar marrja e informacionit nëpërmjet publikimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të DPPM.
- Janë trajnuar vazhdimisht stafi i DPPM dhe i aktorëve të fushës së Pronësisë Industriale duke i dhënë fokus specifikave të kësaj fushe.
- Është ofruar dhënia e informacionit dhe asistencë për plotësimin e dokumentacionit subjekteve të interesuara.

Duke falenderuar të gjithë institucionet shtetërore, partnerët ndërkombëtarë dhe grupet e interesit që dhanë kontributin e tyre në këto arritje, uroj suksese për të gjithë!

Përzemërsisht,

ELVIN LAKO

Drejtor i Përgjithshëm

his event, important strategic meetings were organised between the President of the EPO, Mr. Benoit Battistelli, and the Minister of MEDTTE, Ms. Milva Ekonomi, and also with the Minister for Innovation and the Public Administration, Ms. Milena Harito.

- It became possible to provide new electronic services that expand the spectrum for obtaining information about Industrial Property objects also to the international search system such as TMview and DesignView administered by the EUIPO for Intellectual Property, and access in the Albanian language was made possible on ESPACENET administered by the EPO.
- The GDPT entered into technical cooperation agreements on Intellectual Property with WIPO and EUIPOe and with homologue offices in Turkey, China, and Poland; agreements are in process with other countries.
- Memoranda of cooperation were entered into with the Union of Chambers of Commerce and with the “Luarasi” and “Metropolitan” universities.
- Several open lectures were held in state and private universities for the purpose of encouraging the new generations toward innovation and make them aware of the importance of Industrial Property rights.
- Visits were made to business for the purpose of providing advice and showing the potential those businesses have for the development and protection of Industrial Property in conformity with the needs and their fields of activity.
- Transparency was increased and it was made easier to obtain information through the continuous publication of the activities of the GDPT.
- The staff of the GDPT and actors in the field of Industrial Property were constantly trained, giving focus to the specifics of this field.
- Information and assistance were provided to interested subjects for completing documentation.

Thanking all state institutions, international partners and interest groups which have given their contribution to these achievements, I wish success to all!

With warmest regards,

ELVIN LAKO

Director General



“Zemra dhe Shpirti i Kompanisë... Pronësia Industriale”

I. PRONËSIA INTELEKTUALE

Sistemi i Pronësisë Intelaktuale është mjeti juridik që siguron mbrojtjen dhe rregullon të drejtat mbi produktet e krijimtarisë intelektuale të mendjes njerëzore.

E drejta e pronësisë mbi asetet jo-fizike siç janë: patentat mbi shpikjet, markat tregtare, disenjt industriale, treguesit gjeografikë apo krijimet artistike janë të njëjta me të drejtat që gëzohen mbi asetet fizike, që do të thotë, se ekziston mundësia ligjore për t'i shitur apo blerë ato, për t'i përdorur dhe shfrytëzuar ato. Këtë të drejtë pronësie e siguron sistemi i Pronësisë Intelaktuale.

Mbrojtja e të drejtave të Pronësisë Intelaktuale nuk është vetëm çështje e të drejtave private, ajo përbën një faktor të rëndësishëm që ndikon në rritjen ekonomike të një vendi, sepse është motori që nxit punën krijuese dhe garanton rregullat e një tregu të bazuar në konkurrencën e ndershme. Për më tepër në ditët e sotme, në kushtet e globalizimit të tregjeve si dhe shtimit të produkteve dhe shërbimeve të reja, mbrojtja e të drejtave mbi pronësinë industriale merr një rëndësi edhe më të madhe.

Pronësia Intelaktuale është e lidhur ngushtë me inovacionin dhe luan rol kyç për nxitjen e tij. Aktiviteti tregtar synon gjithnjë drejt prurjes së risive duke investuar në dije dhe teknologji të reja. Nëse mbrojtja e të drejtave të Pronësisë Intelaktuale nuk do të ishte e fortë dhe efciente, do të krijohej mungesë sigurie dhe frenim për inovacionin. Dihet që sipërmarrja dhe përfshirja në projekte inovative mbart gjithmonë me vete edhe riskun e humbjes dhe të dështimit për biznesin, prandaj mbrojtja e Pronësisë Intelaktuale përbën një lloj suporti dhe garancie për sipërmarrësit, sepse mundëson ndalimin e kujtqo që do synonte të përfitonte pa merituar nga idetë, investimi, dhe reputacioni i tyre pa ndarë kurrfarë risku.

Në mungesë të sistemit të Pronësisë Intelaktuale, pak njerëz do të pranonin riskun që përfshihet në inovacion dhe kjo do të ngadalësonte ritmin e zhvillimit ekonomik, prandaj sa më të forta të jenë politikat e mbrojtjes së sistemit të Pronësisë Intelaktuale në një vend, aq më e zhvilluar do jetë ekonomia e tij.

Pronësia Intelaktuale ndahet në dy degë: Pronësia Industriale dhe E Drejta e Autorit.

Në Shqipëri institucioni përgjegjës për dhënien e të drejtës mbi objektet e Pronësisë Industriale është Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave.

I. INTELLECTUAL PROPERTY

The Intellectual Property system is the legal means that secures the protection of, and regulates, rights to the products of intellectual creativity of the human mind.

The rights of property in intangible assets such as patents for inventions, trademarks, industrial designs, geographic indicators or artistic creations are the same as the rights enjoyed for tangible assets, which means that the legal possibility exists to sell or buy them, to use and exploit them. It is the Intellectual Property system that assures those rights.

The protection of Intellectual Property rights is not only a question of private rights; it constitutes an important factor affecting the economic growth of a country, because it is the motor that encourages creative work and guarantees the rules in a market based on honest competition. Furthermore, under today's conditions of the globalization of markets, as well as the increase of new products and services, the protection of the rights to industrial property assumes even greater importance.

Intellectual property is closely linked to innovation and plays a key role in encouraging it. Commercial activity is always aimed in the direction of drawing out innovations, investing in new technologies and knowledge. If the protection of Intellectual Property rights were not to be strong and efficient, an absence of security would be created and innovation would be braked. It is known that entrepreneurship and involvement with innovative projects always carries with itself the risk of loss and failure for business, so the protection of Intellectual Property constitutes a kind of support and guarantee for entrepreneurs, because it makes it possible to stop anyone who may be trying to benefit undeservedly from their ideas, investment and reputation without ever sharing the risk.

In the absence of a system of Intellectual Property, few people would accept the risk entailed in innovation, and this would slow the rhythm of economic development. Therefore, the stronger the policies in a country for protecting the system of Intellectual Property are, all the more developed will its economy be.

Intellectual Property is divided into two branches: Industrial Property and Copyright.

The institution in Albania responsible for granting rights for objects of Industrial Property is the General Directorate of Patents and Marks (GDPT).

II. POLITIKAT AKTUALE PËR ZHVILLIMIN E PRONËSISË INTELEKTUALE NË SHQIPËRI

Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020

"Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020" miratuar me vendimin nr. 527, datë 20.07.2016, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr.140 të datës 28.07.2016 është një nga dokumentet më të rëndësishme në fushën e garantimit të mbrojtjes së të drejtave të PI në Shqipëri. DPPM në rolin e Sekretariatit Teknik ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e kësaj strategjie. Në datë 31.03.2016, Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 112 datë 26.08.2015, përfundoi hartimin e dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020. Hartimi i këtij dokumenti u asistua nga përfaqësues të OBPI. Raporti i përgatitur nga ekspertët e delegacionit të OBPI u hartua mbështetur në analizën e bazës së të dhënave të DPPM, në intervistat e organizuara me institucionet e përfshira në sistem si dhe me grupet e interesit.



Vizioni i Qeverisë Shqiptare, lidhur me Sistemin e Mbrojtjes së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në këtë Strategji është një sistem më i fortë i PI në Republikën e Shqipërisë, i cili siguron një mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në funksion të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Prioritetet strategjike janë hartuar edhe në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga:

- (1) Dokumenti i Partneritetit Evropian (EPD);
- (2) Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA);
- (3) Progres Raportet e KE- së për Shqipërinë
- (4) Marrëveshja TRIPS dhe Acquis i BE-së.

II. CURRENT POLICIES FOR THE DEVELOPMENT OF INTELLECTUAL PROPERTY IN ALBANIA

The National Strategy for Intellectual Property 2016-2020

"The National Strategy for Intellectual Property 2016-2020", approved by Council of Ministers decision no. 527 dated 20.07.2016, published in Official Journal no. 140 dated 28.07.2016, is one of the most important documents in the field of guaranteeing the protection of IP rights in Albania. In the role of Technical Secretariat, the GDPT played an important role in drawing up this strategy. On 31.03.2016, the Inter-institutional Working Group created by Prime Minister's Order no. 112 dated 26.08.2015 finished drafting the strategic document for Intellectual Property 2016-2020. WIPO representatives assisted in the preparation of this document. The report prepared by experts of the WIPO delegation was supported on an analysis of the GDPT data base, interviews organised with the institutions involved in the system as well as with interest groups.

The vision of the Albanian Government in connection with the System of Protection of the Rights of Intellectual Property in this strategy is a stronger IP system in the Republic of Albania that assures effective protection of IP objects, encourages creativity and innovation in the stimulation of economic growth and cultural and scientific development in the Republic of Albania.

The strategic priorities were also drawn up in compliance with the obligations that come from:

- (1) The European Partnership Document (EPD);
- (2) The Stabilisation-Association Agreement (SAA);
- (3) The EC Progress Report for Albania;
- (4) The TRIPS Agreement and the EU Acquis.

Fokusi i saj është përmirësimi i funksionimit të sistemit të PI me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta. Në mënyrë specifike ajo do të mund të shërbejë si një mjet i politikës për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe garanton suksesin në treg.

Kjo Strategji synon rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga PI, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë.

Strategjia përcakton lidhjet ndërmjet politikave kombëtare në fusha të ndryshme për të pasur një koordinim efektiv për zbatimin e PI. Forcimi i sistemit të PI luan rol shumë të rëndësishëm për një konkurrencë të ndershme në treg, mbrojtjen e konsumatorit, krijimin e besueshmërisë në treg për investime në kërkim dhe zhvillim, e si pasojë shërben për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik të një vendi.

Kjo strategji do të ndikojë mbi një sërë politikash sektoriale, të tilla si politikat e zhvillimit të industrisë, politikat e përmirësimit të konkurrueshmërisë në treg, për përmirësimin e klimës së biznesit dhe politikat për mbrojtjen e konsumatorit.

Theksojmë që në strategjinë e re parashikohet anëtarësimi i Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës.

Kjo marrëveshje mundëson regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë, të cilët kanë të bëjnë me produkte agrokulturore, ushqimore apo artizanale të cilat kanë karakteristika që burojnë nga kushtet klimaterike dhe traditat e zonës ku ato prodhohen. Mbrojtja nga falsifikimi i treguesve gjeografikë sigurohet nëpërmjet regjistrimit dhe ofron një treg të sigurt për investitorët e huaj dhe vendas, si dhe cilësi të garantuar për konsumatorët e këtyre produkteve.

Identifikimi i këtyre produkteve në vendin tonë dhe regjistrimi i tyre do të nxisë rritjen ekonomike në zonat rurale, si dhe eksportin e produkteve shqiptare në tregun e huaj, duke i bërë këto produkte shqiptare të njohura në botë.

Qëllimet strategjike

Qëllimi i Qeverisë Shqiptare në fushën e Pronësisë Intelktuale është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të përshtatshëm të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të Pronësisë Intelktuale dhe interesave të përdoruesve si dhe të forcojë sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes së PI.

Its focus is improving the functioning of the IP system, for the purpose of encouraging and supporting innovation by encouraging research work, in particular by Albanian companies and citizens on the road to economic development and toward the highest standards. Specifically, this might serve as a policy means to encourage investments and research and development, as well as guaranteeing success in the marketplace.

This Strategy aims at increasing awareness as well as strengthening the system of registration, administration and protection of the rights that derive from IP, as rights that have a powerful influence on the development and good functioning of the economy.

The Strategy defines the links between national policies in various fields in order to have effective coordination for the implementation of IP. The strengthening of the IP system plays a very important role in honest competition in the marketplace, consumer protection, the creation of trust in the market for investments in research and development and, as a consequence, serves cultural, social and economic development in the country.

This Strategy will have an effect on a series of sector policies, such as the policies of industrial development, the policies of improving competitiveness in the marketplace, the improvement of the business climate and the policies for consumer protection.

We emphasise that it is foreseen in the strategy that Albania will become a member of the Lisbon agreement.

This agreement enables the registration of geographic indicators, which have to do with agricultural and food products or handicrafts that have characteristics stemming from the climatic conditions and traditions of the area where they are produced. The protection of geographic indicators from falsification is secured through registration and provides a secure market for local and foreign investors, as well as guaranteed quality for consumers of those products.

The identification of these products in our country and their registration will encourage economic growth in rural areas, as well as the export of Albanian products into foreign markets, making those Albanian products known in the world.

The strategic purposes

The purpose of the Albanian Government in the Intellectual Property field is to stimulate economic, scientific and cultural development in the country, to assure the appropriate functioning of the internal market by establishing the appropriate balance between the rights of owners of Intellectual Property objects and the interests of users, as well as to strengthen the system of IP registration and protection.

Ky qëllim arrihet nëpërmjet:

- Ofrimit të një sistemi të besueshëm dhe efikas të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale;
- Nxitjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit ekonomik të Pronësisë Intelektuale.

This purpose is achieved through:

- Providing a credible and efficient system of protection of Intellectual Property rights;
- Encouraging the development and economic exploitation of Intellectual Property.

Katër objektivat e Strategjisë:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor;
2. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale;
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës në mbrojtje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale; 4
4. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit në lidhje me PI në vend.

The four objectives of the Strategy:

1. Improvement of the legal framework;
2. Development and strengthening of the institutions involved in the implementation of Intellectual Property rights;
3. Strengthening of cooperation and coordination among the institutions, both at the national level as well as the regional level and more broadly, in the service of improvement of the work to protect Intellectual Property rights;
4. Raising of the level of awareness in relation to IP in the country.

DPPM, si Sekretariati Teknik i Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të Strategjisë ka koordinuar punën, ka patur rolin qëndror në mbledhjen e informacionit nga institucionet të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për masat respektive që ato kanë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie dhe organizon takimet e këtij Grupi.

As the Technical Secretariat of the Inter-institutional Working Group for monitoring and coordinating implementation of the Strategy, the GDPT has coordinated the work, has played a central role in collecting information from the institutions that are directly responsible for the respective measures foreseen in the Action Plan of this Strategy and organises the meetings of this Group.

1. Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, të ndryshuar

Ligji nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 55/2014, u përafua plotësisht me Direktivat e Bashkimit Evropian. Ligji 55/2014 përmirësoi kuadrin ligjor për mbrojtjen e Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë dhe e solli atë në linjë me standardet dhe *acquis* e BE, si dhe me kërkesat e Konventës Evropiane të Patentave. Miratimi i ndryshimeve në ligjin “Për Pronësinë Industriale” përmbushi një nga rekomandimet e bëra nga Komisioni Evropian në Progres-raportin për vitin 2013 për Shqipërinë.

Por, në këtë ligj, (Ligji 55/2014) edhe pse ishte përgatitur nga ekspertë evropiane dhe konsiderohej si i përfunduar nga Komisioni Evropian, nuk gjenin zbatim rekomandimet e raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian të nëntorit 2013, i cili ngrinte një sërë çështjesh të rëndësishme për t'u zgjidhur si hartimi i kritereve për markat e mirënjohura, hartimi i kritereve për ekspertët e PI në Gjykata, përmirësimi i

1. The draft law for some additions and amendments to law no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property”, amended

Law no. 9947 dated 7.7.2008 “On industrial property”, amended and supplemented with law no. 55/2014, was approximated entirely with the Directives of the European Union. Law no. 55/2014 improved the legal framework for the protection of Industrial Property in the Republic of Albania and brought it into line with the standards and *acquis* of the EU, as well as the requirements of the European Patent Convention. The approval of amendments to the law “On industrial property” fulfils one of the recommendations made by the European Commission in the Progress Report for Albania for the year 2013.

But in that law (no. 55/2014), although it was prepared by European experts and was considered concluded by the European Commission, does not implement the recommendations of the evaluation report of the European Commission of November 2013, which raised a series of importance issues to be resolved such as the drafting of criteria for well-known marks, the drafting of criteria for IP experts in the courts, the

cilësisë së ekzaminimit, aplikimet on-line si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të drejtorisë.

Bazuar në parashikimet e Strategjisë Kombëtare për PI 2016-2020, si dhe për të siguruar një sistem më efektiv të mbrojtjes së këtyre të drejtave, DPPM hartoi projektligjin e ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, të ndryshuar”.

Qëllimi i hartimit të këtij projektligji ishte përmbushja e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikatat e zyrave homologe ndërkombëtare.

Gjithashtu hartimi i këtij projektligji i shërben përmbushjes së angazhimeve dhe synimeve të qeverisë shqiptare të cilat kanë të bëjnë me shkurtimin e afateve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit aktual në praktikë, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikatat e zyrave homologe ndërkombëtare.

Konkretisht objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- Lehtësimi i procedurave të ekzaminimit, si dhe krijimi i një mjedisi ligjor për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit. Krijimi i mundësisë së aplikimit on-line në funksion të lehtësimit të procedurave.
- Krijimi i bazës ligjore për sigurimin e objekteve të PI-së, si dhe për përdorimin e tyre si kolateral, me qëllim që objektet e PI-së të marrin në treg vlerën që u takon.)
- Rregullimi i disa procedurave dhe kompetencave të DPPM, bazuar në praktikën e kombëtare dhe atë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit në fushën e PI-së.
- Përcaktimi ligjor i kriterëve për markat e mirënjohura.
- Krijimi i bazës ligjore për liçensimin e ekspertëve të PI nga DPPM për nevojat e proceseve gjyqësore dhe të hetimit.
- Krijimi i bazës ligjore për krijimin e dhomës së shqyrtimit të kërkesave për shfuqizim/zhvlerësim si dhe dhomës për shqyrtimin e kundërshtimeve, si struktura brenda DPPM.
- Përcaktimi i kompetencave të dhomës për shfuqizim/ zhvlerësim si dhe dhomës për shqyrtimin e kundërshtimeve.
- Saktësimi i procedurave për rregjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emertimeve të origjinës me qëllim eliminimin e problemeve të hasura në praktikë.
- Rikompozimi i Bordit të Apelit si një strukturë edhe me ekspertë të jashtëm, dhe pajisja e tij kompetenca të rëndësishme ligjore.
- Rishikimi i kriterëve për liçensimin e përfaqësuesve të autorizuar.
- Ndryshimi i emërimit dhe strukturës administrative të DPPM nga një institucion publik buxhetor në një Agjenci Autonome në bazë të neneve 10 e 20 të

improvement of the quality of examination, applications on-line as well as strengthening the administrative capacities of the directorate.

Based on the provisions of the National Strategy for IP 2016-2020, and also in order to assure a more effective system of protection of those rights, the GDPT drafted a new law “On some additions and amendments to law. no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property”, amended.

The purpose in drafting this law was to fulfil the duties assigned in reports of the European Commission as well as adaptation based on the experiences and practices of homologous international offices.

In addition, the drafting of this law serves to meet the commitments and aims of the Albanian government having to do with shortening the time periods and raising the quality of service, regulations and clarifications of problems met with from implementation of the current law in practice, as well as adaptation to the experiences and practices of homologous international offices.

Concretely, the objectives intended to be achieved through this draft law are:

- Making the examination procedures easier, as well as creating a legal environment for the improvement of electronic services and communications services. Creation of the opportunity to apply on-line to facilitate the procedures.
- Creation of the legal basis to secure IP objects as well as their use as collateral, so that the IP objects will take on the value they merit in the marketplace.
- Regulation of certain procedures and competences of the GDPT, based on national and international practice of implementing the law in the IP field.
- The legal definition of the criteria for well-known trademarks.
- Creation of the legal basis for licensing IP experts by the GDPT for the needs of investigation and judicial proceedings.
- Creation of the legal basis for establishing a chamber of examination of requests for cancellation or invalidation, as well as a chamber for examination of oppositions, as structures within the GDPT.
- Improvement of the competences of the chamber for cancellation and invalidation of marks as well as the chamber for examining oppositions.
- Clarification and making precise of the procedures for registration of geographic indicators and designations of origin, for the purpose of eliminating problems met with in practice.
- Recomposition of the Board of Appeal as a structure also containing outside experts and supplied with important legal competences.
- Review of the criteria for licensing authorised representatives.
- Change of the appointment and administrative structure of the GDPT from a public budgetary institution into an Autonomous Agency on the basis of articles 10

Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore,” me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj.

and 20 of law no. 90/2012 “On the organisation of the state administration,” for the purpose of strengthening administrative and financial capacities as a main element of realisation of its mission.

Në projektligj gjejnë zbatim Direktivat e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC “Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike.” (*Reflektimi rekomandimeve nga delegacioni i KE në Tiranë*)
- Direktiva 2015/2436/EC, dt.16.12.2015 “Për përafrimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat.” (*Me iniciativën e DPPM-së si dhe bazuar në rekomandimet e OBPI-s, ZBEPI-s dhe delegacioni i KE në Tiranë.*)
- Rregullorja Nr. 1151/2012/EC dt. 21.11.2012 “Për skemat e cilësisë për produktet agrikulturore dhe ushqimore.” (*Me iniciativë e DPPM-së si dhe bazuar në rekomandimet e ekspertit të projektit FAO*)
- Rregullorja Nr. 1308/2013/EC dt.17.12.2013 “Për themelimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve agrikulturore dhe shfuqizimi i rregulloreve (EEC) No 922/72, (EEC) No 234/79, (EC) No 1037/2001 and (EC) No 1234/2007.” (*Me iniciativë e DPPM-së si dhe bazuar në rekomandimet e ekspertit të projektit FAO*)

Në lidhje me ndryshimet ligjore për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës DPPM bashkëpunoi në kuadër edhe të projektit FAO me ekspert të huaj i cili ndihmoi në përmirësimin e bazës ligjore në përputhje me dy rregullore të Komisionit Europian të dala në periudhën 2012-2016, si dhe për njehsimin e procedurave me institucionet e tjera të përfshira në sistemin e mbrojtjes dhe regjistrimit të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës si Ministria e Bujqësisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Theksojmë se i njëjti ekspert i këtij projekti asiston aktualisht edhe këto institucione në përmirësimin e bazës ligjore në lidhje me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

*** Projektligji “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9947, Datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, të ndryshuar” u miratua në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me Ligjin 17/2017, më datë 16.02.2017 dhe hyri në fuqi më datë 25.03.2017.**

The following EU Directives are implemented in the draft law:

- Directive 98/44/EC “On the legal protection of biotechnological inventions” (*Reflection of recommendations from the EU Delegation in Tirana*)
- Directive 2015/2436/EC, dt. 16.12.2015 “On the approximation of the legal basis of Member States in connection with trademarks.” (*On the initiative of the GDPT and based on recommendations of WIPO, EUIPO and the EU Delegation in Tirana*).
- Regulation no. 1151/2012/EC dt. 21.11.2012 “On quality schemes for agricultural and food products” (*On the initiative of the GDPT and based on the recommendations of experts of the FAO project*)
- Regulation no. 1308/2013/EC dt. 17.12.2013 “On establishing a joint organisation of agricultural product markets and the repeal of regulations (EEC) n 922/72, (EEC) no 234/79, (EC) no 1037/2001 and (EC) no 1234/2007.” (*On the initiative of the GDPT and based on recommendations of the expert of the FAO project*)

In connection with the legal amendments about geographic indicators as well as designations of origin, the GDPT also cooperated in the framework of the FAO project, with a foreign expert who assisted in the improvement of the legal basis in conformity with two regulations of the European Commission issued in the period 2012-2016, as well as for the unification of procedures with other institutions involved in the system of protection and registration of geographic indicators and designations of origin, such as the Ministry of Agriculture and the National Foot Authority.

We emphasise that the same expert from this project is also currently assisting those institutions in improving the legal basis related to geographic indicators and designations of origin.

*** The draft law “For some additions and amendments to law no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property”, amended, was approved in the Assembly of the Republic of Albania by law no. 17/2017 dated 16.02.2017 and entered into force on 25.03.2017.**

III. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

STATUSI

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është institucion buxhetor publik i krijuar në mbështetje të Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar dhe është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat e shpikjeve dhe modele të përdorimit, topografinë e produkteve gjysmë-përçues, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjt industrial dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të të drejtave pronësinë mbi këto objekte nëpërmjet regjistrimit. DPPM është institucion në varësi të MZHETTS

MISIONI

DPPM ka si mision të forcojë mbrojtjen e Pronësisë Industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

KOMPETENCAT

- Ushtrimi i kompetencave ekzekutive në fushën e Pronësisë Industriale.
- Ekzaminimi i aplikimeve për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale.
- Regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale dhe lëshimi i çertifikatave të regjistrimit.
- Mbajtja e regjistrave të objekteve të Pronësisë Industriale të regjistruara për territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Lëshimi i vërtetimeve mbi statusin e objekteve të Pronësisë Industriale si dhe i ekstrakteve të regjistrimit.
- Promovimi dhe trajnimi i aktorëve të përfshirë në sistemin mbi të drejtat dhe rëndësinë e Pronësisë Industriale me qëllim nxitjen, zhvillimin dhe forcimin e mbrojtjes së saj.
- Koordinimi i punës dhe marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare të PI në të cilat Shqipëria është anëtare.
- Pjesëmarrja në komitetet dhe takimet e organizuara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe Organizata Evropiane e Patentave.
- Publikimi i buletineve me të dhënat mbi aplikimet në DPPM.
- Shqyrtimi dhe vendimarrja mbi kundërshtimet ndaj aplikimeve për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale në Bordin e Apelit.
- Liçensimi i përfaqësuesve të autorizuar për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale.

III. GENERAL DIRECTORATE OF PATENTS AND MARKS

STATUS

The General Directorate of Patents and Marks is a public budgetary institution created in reliance on law no. 9947 dated 07.07.2008 "On industrial property", amended, and is the only institution through which the Albanian state grants rights to patents for inventions and utility models, the topography of semi-conductor products, trademarks and service marks, industrial designs and geographic indicators, recognising to their holders the rights of ownership over those objects through registration. The GDPM is an institution under the MEDTTE.


MISION

The GDPM has the mission of strengthening the protection of Industrial Property within Albanian territory through recognition, registration and promotion of those rights in order to guarantee a level of protection the same as that of the countries of the European Union.

COMPETENCES

- The exercise of exclusive competences in the field of Industrial Property.
- The examination of applications for the registration of Industrial Property objects.
- The registration of industrial property objects and the issuance of certificates of registration.
- The maintenance of registers of Industrial Property objects registered for the territory of the Republic of Albania.
- The issuance of certifications about the status of Industrial Property objects as well as extracts from the register.
- Promoting and training acts involved in the system of rights and promoting the importance of Industrial Property for the purpose of encouraging, developing and strengthening its protection.
- The coordination of work and relationships with IP international organisations in which Albania is a member.
- Participation in committees and meetings organised by the World Intellectual Property Organisation and the European Patent Organisation.
- The publication of bulletins with data about applications to the GDPM.
- The examination of and decision-making about oppositions to applications for the registration of Industrial Property objects in the Board of Appeal.
- The licensing of authorised representatives for the registration of objects of Industrial Property.

STRUKTURA E DPPM THE STRUCTURE OF THE GDPT





IV. SHËRBIME TË REJA

Analiza e Pronësisë Intelektuale

Analiza e Pronësisë Intelektuale aplikohet për herë të parë në Shqipëri dhe është tashmë një shërbim i ri që DPPM ofron falas për publikun. Në këtë mënyrë biznesi shqiptar, shoqëritë e mëdha tregtare, por edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme asistohen nga stafi i DPPM për evidentimin e objekteve të tyre të PI me qëllim që ato të zhvillohen dhe të mbrohen nëpërmjet regjistrimit. Specialistët e DPPM kryejnë takime me biznesin dhe japin këshilla direkte pasi analizojnë nevojat dhe situatën konkrete të tyre. Ky aktivitet gjithashtu është një mundësi shumë e mirë për promovimin e sistemit të PI në Shqipëri.

Zbatimi i Analizës së Pronësisë Intelektuale ka qenë një nga sfidat e DPPM në vitin 2016.

Metodologjia e kësaj analize është projektuar nga ZEP. Tani Shqipëria përfshihet në listën e vendeve anëtare të ZEP që e implementon këtë analizë. ZEP gjithashtu mundësoi trajnimin e stafit të DPPM për mënyrën e se si kryhet Analiza e Pronësisë Intelektuale duke filluar me evidentimin e bizneseve, kontaktimin, zhvillimin e intervistave dhe hartimin e raporteve të Analizës së Pronësisë Intelektuale.

Publikim çdo muaj të Buletinit të aplikimeve për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale

Në vitin 2016, DPPM vendosi që buletinët me informacione për markat tregtare dhe të shërbimit, treguesit gjeografikë, disenjot industriale të publikohen periodikisht çdo muaj, nga një herë në dy muaj që kryhej më parë. Publikimi i shpeshtë i buletinëve i vjen në ndihmë publikut të marrë dijeni në kohë dhe rregullisht mbi çdo aplikim të paraqitur në DPPM për regjistrim të objekteve të Pronësisë Industriale. Gjithashtu shpeshtimi i publikimeve ndikon në shkurtime të procedurave të regjistrimit duke u mundësuar aplikantëve të marrin sa më shpejt në duar certifikatat e regjistrimit, kur këto aplikime rezultojnë të suksesshme.

IV. NEW SERVICES

Analysis of Intellectual Property

Analysis of Intellectual Property is applied for the first time in Albania and is now a new service that the GDPT offers for free to the public. In this way, Albanian business, large commercial companies but also small and medium enterprises, are assisted by the staff of the GDPT for showing their IP objects, for the purpose of developing and protecting them through registration. The specialists of the GDPT hold meetings with business and give direct advice after they analyse their needs and the concrete situation.

This activity is also a very good opportunity for promotion the IP system in Albania.

The implementation of the Analysis of Intellectual Property has been one of the challenges of the GDPT in 2016. The methodology of this analysis has been projected by the EPO. Albania is included in the list of EPO member countries that implement this analysis. The EPO also makes it possible to train the staff of the GDPT about how to make an Analysis of Intellectual Property, beginning with identifying the businesses, contacting them, holding interviews and preparing reports about the Analysis of Intellectual Property.

Publication of the Bulletin of applications for registration of IP objects every month

In 2016, the GDPT decided that the bulletins with information about trademarks and service marks, geographic indicators and industrial designs would be periodically published every month, up from once every two months, which had been the previous practice. The frequent publication of bulletins comes to the aid of the public to obtain knowledge in a timely and regular basis about every application submitted to the GDPT for the registration of Industrial Property objects. In addition, making publications more frequent has an effect on shortening the time of the procedures of registration, enabling applicants to receive in their hands as quickly as possible certificates of registration when those applications turn out to be successful.



Përditësimi çdo javë i regjistrave on-line për patentat mbi shpikjet, disenjot industriale dhe markat tregtare nga një herë në çdo muaj që ishte më parë

Në faqen e zyrtare të DPPM është e mundur që publiku të ketë akses on-line në databasën e të dhënave të DPPM. Ky akses mundëson orientimin e publikut në lidhje me statusin dhe pronësinë e objekteve të Pronësisë Industriale, si dhe mundëson transparencën e aktivitetit të DPPM në lidhje me procedurat e ekzaminimit.

Integrimi në modulet TMclass, TMview dhe DesignView

TMclass, TMview dhe DesignView janë sisteme kërkimi të menaxhuara nga Zyra Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelktuale për mallrat dhe shërbimet sipas klasifikimit të Nicës, markat tregtare dhe disenjot industriale.

Në bashkëpunim me ZBEPI në muajin Maj 2016 u mundësua integrimi në modulën TMClass, për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve (Klasifikimi i Nicës).

Në datën 04 korrik 2016, u mundësua aksesimi në gjuhën shqipe i sistemit të kërkimit TMview, i cili me shtimin e më shumë se 12.000 markave tregtare të regjistruara në Shqipëri, tashmë TMview jep informacion dhe akses për rreth 40 milion marka tregtare në total, në këtë mënyrë kompanitë e huaja mund të marrin informacion për markat dhe disenjot industriale të mbrojtura në Shqipëri. Ky regjistër përditësohet çdo ditë me markat e publikuara.

Gjithashtu është mundësuar integrimi i të dhënave të regjistrimit të DPPM në modulën DSview baza e të dhënave on-line për disenjot industriale nga aktualisht 49 zyra pjesëmarrëse. Kjo ndërfaqe është e aksesueshme në gjuhën shqipe dhe përmban edhe të dhënat e regjistrimit të disenjove industriale të DPPM.

Po në të njëjtën datë, 04.04.2016, mundësua aksesimi në gjuhën shqipe i sistemit të kërkimit DesignView, i cili është sistem i menaxhuar nga ZBEPI për kërkimin e disenjove industriale. Me shtimin disenjove industriale të regjistruara në Shqipëri. Ky regjistër përditësohet çdo ditë me disenjot industriale të publikuara.

Shërbimet e lartpërmendura i bëjnë të njohura në gjithë Evropën objektet e Pronësisë Industriale të

Updating the on-line registers for patents on inventions, industrial designs and trademarks every week, from once a month which it was before

On the official web page of the GDPT, it is possible for the public to have on-line access to the data base of the data of the GDPT. This access makes it possible for the public to be oriented about the status and ownership of Industrial Property objects, as well as making it possible for the activity of the GDPT to be transparent in connection with examination procedures.

Integration with the models TMclass, TMview and DesignView

TMclass, TMview and DesignView are search system managed by the European Union Intellectual Property Office for goods and services according to the Nice classification for trademarks and industrial designs.

In cooperation with the EUIPO, integration with the TMclass model for the International Classification of Marks and Services (Nice Classification) was made possible in May 2016.

On 04 July 2016, access was made possible in the Albanian language of the search system TMview, which with the addition of more than 12,000 trademarks registered in Albania, now gives information about and access to about 40 million trademarks in total. In this way, foreign companies can get information about trademarks and industrial designs protected in Albania. This register is updated daily with published marks.

In addition, the integration of data from the GDPT register has been made possible in the DSview module, an on-line data base for industrial designs from, currently, 40 participating offices, also containing the data of the GDPT's register of industrial designs.

Also on the same day, 04.04.2016, access to the search engine DesignView was made available in the Albanian language, an engine managed by the EUIPO for searching for industrial designs. Now industrial designs registered in Albania are added. This register is updated every day with industrial designs that are published.

The above-mentioned services make objects of Industrial property protected in Albanian known

mbrojtura në Shqipëri, duke zgjeruar territorin ku shpërndahet informacioni mbi markat tregtare dhe disenjot industriale arrihet edhe forcimi i mbrojtjes dhe shtimi i reputacionit të tyre. Gjithashtu përdorimi i këtyre të dhënave lehtëson kompanitë e huaja që kërkojnë të mbrohen në Shqipëri të marrin informacion në kohë reale mbi statusin e aplikimeve të tyre. Kjo gjë rrjedhimisht ndikon në shtimin e aplikimeve nga subjektet e huaja në Shqipëri.

Espacenet në gjuhën Shqipe

Në datën 31.08.2016 u mundësua aksesimi në gjuhën shqipe në Espacenet, i cili është një sistem kërkimi i ZEP, që ofron pa pagesë informacionin rreth shpikjeve dhe zhvillimeve teknologjike që nga shekulli i 19-të e deri sot. Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi kërkimi shpikësit shqiptar, bizneset apo qendrat e kërkimit, por edhe fillestarët mund të marrin informacion nëse një patentë është lëshuar dhe nëse është ende në fuqi.

Gjithashtu Espacenet shërben për të kërkuar dhe gjetur publikimet e patentave, përkthyer dokumentat nga makina e përkthimit, për të ndjekur përparimin e teknologjive të reja, për të gjetur zgjidhje të problemeve teknike, apo për të parë se çfarë janë duke zhvilluar konkurentët. Espacenet u krijua në vitin 1998 nga ZEP.

Me krijimin e këtij sistemi kërkimi është revolucionarizuar aksesimi i publikut në informacionin mbi patentat ndërkombëtare, duke i liruar të dhënat e patentave nga burgjet prej letre dhe duke ndryshuar përgjithmonë mënyrën se si merret informacioni mbi patentat, si shpërndahet, organizohet dhe kontrollonhet. Ai përmban të dhëna për më shumë se 80 milion dokumenta të patentave në mbarë botën.

Përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit të objekteve të Pronësisë Industriale dhe shkurtimi i procedurës së regjistrimit

Me qëllim ofrimin e shërbimit më të shpejtë ndaj publikut DPPM u angazhua duke ekzaminuar të gjitha aplikimet depozituara në 2016 që në muajin parë nga tre muaj që është parashikimi në ligj, gjithashtu u mundësua publikimi më i shpeshtë i buletinëve duke shkurtuar ndjeshëm procedurat e regjistrimit, në mënyrë që aplikantët të arrijnë të marrin në duar certifikatat e regjistrimit brenda 5-muajve. Përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit u rrit ndjeshëm edhe falë asistencës së ekzaminuesve në konsultimet e ofruara me aplikantët e këtyre objekteve. Të gjitha dokumentat e kthyer nga posta janë skanuar dhe u janë nisur aplikantëve me e-mail duke ndikuar ndjeshëm në mbylljen e procedurave të regjistrimit.

throughout Europe, expanding the territory where information is disseminated about trademarks and industrial designs., also strengthening their protection and adding to their reputation. In addition, the use of this data makes it easier for foreign companies who want their IP to be protected in Albania to obtain information in real time about the status of their applications. In consequence, this has an effect on increasing applications from foreign subjects in Albania.

Espacenet in the Albanian language



On 31.08.2016, access was made possible in the Albanian language to Espacenet, which is a search engine of the EPO, which offers information, without payment, about inventions and technological developments from the 19th century until the present day. Through the use of this search engine,

Albanian inventors, businesses or research centres, as well as start-ups, can get information about whether a patent has been issued and whether it is still in force.

In addition, Espacenet serves to search for and find publications of patents, translated, with documents translated by translation machines, in order to follow the progress of new technologies, to find solutions to technical problems or to see whether competitions are being held.

Espacenet was created in 1998 by the EPO. The access of the public to information about international patents was revolutionised with the introduction of this search engine, releasing patent data from paper prisons and changing forever the way in which information about patents is obtained, how it is disseminated, organised and checked. It contains data for more than 80 million patent documents from all around the world.

Improvement of the quality of examination of Industrial Property objects and shortening the time of the registration procedure

For the purpose of providing the fastest service to the public, the GDPT undertook to examine all the applications filed in 2016 in the first month rather than the three months provided by law and also made publication of its bulletins more frequent, significantly reducing the registration procedures, so that applicants could receive certificates of registration in their hands within a five month period. The quality of examination improved significantly thanks also to the assistance of examiners in consultations provided to the applicants for those objects. All documents returned by post were scanned and sent out to applicants by e-mail; with a significant effect on completing the registration procedures.

Për herë të parë që nga aderimi në marrëveshjen dhe protokollin e Madridit u përgatit e gjithë infrastruktura në bazën e të dhënave, si dhe u shoqërua me të gjitha aktet administrative që përdoren për ekzaminimin e këtyre aplikimeve. Në korrik të këtij viti u nisën në OBPI, edhe dokumentat e para nga zyra me informacionin mbi markat e ekzaminuara, si rezultat u regjistruan gjithsej 2362 marka si dhe u reflektuan në regjistër ndryshimet e 3954 markave.

Skanimi i arkivës së markave si dhe pastrimi i të dhënave të cilat u realizuan po këtë vit nga punonjësit e marrë me kontratë ndikuan ndjeshëm në lehtësimin e punës për ekzaminim të objekteve të Pronësisë Industriale.

Po këtë vit u hartua për herë të parë edhe udhërrefyesi për ekzaminimin e markave. Udhërrefyesi do të jetë një ndihmë për ekzaminuesit për standartizimin e procesit të ekzaminimit në përgjithësi. Vlen të përmendim se pasurimi i këtij udhërrefyesi do të jetë pjesë e punës në vazhdim rast pas rasti i drejtorisë së ekzaminimit.

REKORD HISTORIK APLIKIMESH NË DPPM!

Në vitin 2016, DPPM shënoi numrin më të madh ndër vite të aplikimeve për regjistrim të markave tregtare dhe patentim të shpikjeve.

1055 aplikime për regjistrim markash tregtare dhe 23 aplikime për patenta mbi shpikjet dhe 4 aplikime për modele përdorimi nga shpikësit shqiptarë.

Në mënyrë të veçantë janë inkurajuar shpikësit shqiptarë. DPPM ka bërë përpjekje për t'i identifikuar ata dhe i ka ftuar të paraqiten pranë DPPM për mbrojtje të shpikjeve të tyre. Gjithashtu janë prezantuar edhe lehtësirat ligjore që përfitojnë shpikësit që ndjekin studimet universitare, pensionistët ose personat me aftësi të kufizuara në lidhje me tarifat e reduktuara prej vetëm 100 lekësh me qëllim nxitjen e tyre për aplikim pranë DPPM. Shpikësit janë pritur nga stafi i DPPM dhe janë asistuar për plotësimin e dokumentacionit dhe shpjegimin e procedurës të aplikimit për patentimin e shpikjeve.

Edhe për aplikantët për regjistrimin e markave nuk ka munguar dhënia e informacionit për çështje specifike në lidhje me aplikimin dhe procedurat e regjistrimit. E gjithë puna e përkushtuar e stafit të DPPM u finalizua me arritjen e shifrës rekord të aplikimeve.

Ky është gjithashtu tregues që biznesi shqiptar ka filluar të ndërjegjësohet për benefitet e mbrojtjes së Pronësisë Industriale.

For the first time since adherence to the Madrid protocol and agreement, all the infrastructure was prepared in the data base and was also accompanied with all the administrative acts and used for the examination of those applications. In July, the first documents were sent to WIPO from the office with information about the marks examined, and as a result, in all, 2362 marks were registered and amendments to e 3954 marks were also reflected in the register.

The scanning of the archive of marks as well as the cleansing of the data base were also realised in this year by contract employees, significantly facilitating the work for the examination of Industrial Property objects.

Also in this year, guidelines were drawn up for the first time for the examination of marks. The guidelines will be an aid for examiners to standardise the examination process. It merits mention that it will be a part of the on-going work for the examination directorate to enrich these guidelines, case by case.

A HISTORICAL RECORD OF APPLICATIONS AT THE GDPT

In 2016, the GDPT marked the greatest number of applications over the years for the registration of trademarks and the patenting of inventions - 1055 applications for registration of trademarks and 23 applications for patents for inventions and 4 applications for utility models by Albanian inventors.

In particular, Albanian inventors have been encouraged. The GDPT has made attempts to identify them and has invited their submissions to the GDPT for the protection of their inventions. In addition, legal facilitations were also provided for inventors who are following university studies, pensioners or disabled persons in connection with reduced tariffs of only 100 lek for the purpose of encouraging them to apply at the GDPT. The inventors have been welcomed by the staff of the GDPT and have been assisted in completing the documentation and given explanations of the procedure for applying to patent their inventions.

For the registration of trademarks as well, the giving of information has not been lacking on specific questions in connection with the application and the procedures of registration. All the devoted work of the staff of the GDPT was rewarded with the record number of applications. This is also an indication that Albanian business has begun to become aware of the benefits of the protection of Industrial Property.



Ka një mënyrë për ta bërë më mirë-
Gjeje.

V. PATENTAT E SHPIKJEVE DHE MODELET E PERDORIMIT

Një patentë është e drejta ekskluzive e dhënë për një shpikje. Me fjalë të tjera, një patentë është e drejta për të shfrytëzuar një produkt ose një proces që zakonisht ofron një mënyrë të re për të bërë diçka, ose ofron një zgjidhje të re teknike për një problem. Për të marrë një patentë, informacionet teknike rreth shpikjes duhet të zbulohen për publikun.

Pronari i patentës mundet që të japë autorizim, apo licencë për palët e tjera për të përdorur shpikjen sipas kushteve kontraktuale të rëna dakord. Pronari mund të shesë të drejtën e shpikjes dikujt tjetër, i cili më pas do të bëhet pronari i ri i patentës. Mbrojtja e patentës zgjat për një periudhë të kufizuar, 20 vjet nga data e depozitimit të kërkesës. Pasi mbaron patenta, shpikja është e lirë për përdorim publik që do të thotë se, çdokush mund të shfrytëzojë për qëllime tregtare atë.

Mbrojtja efektive e patentave inkurajon investimet e mëtejshme në Kërkim dhe Zhvillim dhe është garanci për rritjen e kapitalit. Ajo i jep shtysë inovacionit teknik i cili është thelbësor për konkurrencën dhe rritjen e përgjithshme ekonomike.

Publikimi i patentave mundëson shpërndarjen e dijes së re teknologjike. Tani mbi 80% e kësaj dije në të gjithë botën, mund të gjendet në dokumentat e patentave. Kjo frymëzon shpikjet e tjera dhe në të njëjtën kohë parandalon dublikimin e punës për Kërkim dhe Zhvillim.

V. PATENTS FOR INVENTIONS AND UTILITY MODELS

A patent is an exclusive right given for an invention. In other words, a patent is a right to exploit a product or a process or the make something or which offers a new technical solution to a problem. To obtain a patent, technical information about the invention has to be revealed to the public. The owner of the patent may give authorisation or a licence for other parties to use the invention according to agreed contractual conditions.

The owner may sell the right to the invention to someone else, who then becomes the new owner of the patent. Patent protection extends for a limited period, 20 years from the date of deposit. After the patent ends, the invention is free for public use, which means that anyone can exploit it for commercial purposes.

The effective protection of patents encourages further investments in research and development and is a guarantee for increasing capital. It gives an incentive to technical innovation, which is fundamental to competition and overall economic growth.

The publication of patents enables the dissemination of new technological knowledge. Now, over 80% of this knowledge in the entire world can be found in patent documents. This inspires other inventions and at the same time prevents duplication of work in research and development.

Aplikimet për mbrojtjen e Patentave mbi shpikjeve në DPPM vijnë nga tre rrugë kryesore:

- Aplikime për patenta kombëtare.
- Patenta nga Marrëveshja e shtrirjes me ZEP dhe Konventa Evropiane e Patentave.
- Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat nëpërmjet OBPI.

Gjatë vitit 2016, DPPM ka pranuar **745** aplikime për patenta krahasuar me **539** aplikime të depozituara në vitin 2015, pra kemi një rritje prej **26.7 %** të numrit të aplikimeve për patenta. Nga këto aplikime, **2** vijnë nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat, **23** janë aplikime kombëtare me aplikantë nënshtetas shqiptarë, dhe **720** aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga ZEP të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.

Applications to the GDPT for the protection of patents on inventions come in three main ways:

- Applications for national patents.
- Patents from the EPO extension agreement and the European Patent Convention.
- Applications from the Patent Cooperation Treaty through WIPO.

During 2016, the GDPT accepted **745** applications for patents compared with **539** applications deposited in 2015, that is, we have an increase of **26.7%** of the number of applications for patents. Of those applications, **two** come from the Patent Cooperation Treaty, **23** are national applications with Albanian citizens as applicants, and **720** patent applications are patents issued by the EPO seeking protection in Albania.

Aplikime Applications	Viti 2015 Year 2015	Viti 2016 Year 2016	% e rritjes % of increase
Aplikime për patentë kombëtare <i>National patent applications</i>	17	23	35.30%
Patenta nga Marrëveshja e shtrirjes me ZEP dhe Konventa Evropiane e Patentave <i>Patents from Extension Agreement with the EPO and European Patent Convention</i>	520	720	38.50%
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit mbi Patentat <i>Application for patents from Patent Cooperation Treaty</i>	2	2	0%
TOTALI TOTAL	539	745	38.20%

Gjithashtu gjatë këtij vit ka pasur **4** aplikime për Modele Përdorimi nga **1** që kishte vitin e kaluar.

During this year, there were **four** applications for utility models, compared to **one** in the prior year.


Aplikime Applications	Viti 2015 Year 2015	Viti 2016 Year 2016
Aplikime për Model Përdorimi <i>Utility Model Applications</i>	1	4

Numri i aplikimeve për patentë kombëtare është 6-fishuar krahasuar me vitin 2013.

The number of applications for national patents has sextupled in comparison with 2013.

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve për patenta nga subjekte shqiptare.

The following graph shows the number of applications for patents by Albanian citizens




Numri i patentave nga Konventa Evropiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në vendin tonë është dyfishuar në krahasim me vitin 2013.

The number of patents from the European Patent Convention seeking protection in our country has doubled compared to 2013.

Grafiku i mëposhtëm tregon patentat e mbrojtura në DPPM nëpërmjet Konventës Evropiane të Patentave, 2012-2016.

The following graph shows patents protected by the GDPT through the European Patent Convention from 2012 to 2016.




Numri i aplikimeve në total në vitin 2016 është dyfishuar krahasuar me vitin 2013.

The total number of applications in 2016 was doubled compared to 2013.

Grafiku i mëposhtëm tregon aplikimet për patenta 2012-2016.

The following graph shows patent applications from 2012 to 2016.



Në vitin 2016, për patentat janë lëshuar **4286** akte administrative brenda afateve të parashikuara në ligj dhe në rregulloren e patentave, nga të cilat **664** janë patenta nga Marrëveshja e shtrirjes me ZEP dhe Konventa Evropiane e Patentave, **23** patenta kombëtare, **2** nga Traktati i Bashkëpunimit mbi Patentat dhe **1** model përdorimi. Janë ripërtërirë **2628** patenta dhe janë bërë ndryshime në regjistër për **132** patenta.

In 2016, **4286** administrative acts were issued for patents within the time periods provided by law and the patent regulations, of which **664** were patents from the EPO extension agreement and the European Patent Convention, **23** were national patents, two were from the Patent Cooperation Treaty and one was a utility model. There were **2628** patents renewed and amendments to **132** patents in the register.

Tabela e mëposhtme tregon kërkesat si dhe aktet e lëshuara nga DPPM në vitin 2016.

The following table shows the requests as well as the acts issued by the GDPT in 2016.

		Kërkesa Requests	Akte Office documents
1	Patenta nga Konventa Evropiane e Patentave <i>Patents from European Patent Convention (EPC)</i>	720	664
2	Patenta kombëtare <i>National Patents</i>	23	23
3	Patenta nga Traktati i Bashkëpunimit mbi Patentat <i>Patents from Patent Cooperation Treaty (PCT)</i>	2	2
4	Certifikata të mbrojtjes shtesë <i>Supplementary Patent Certifications</i>	2	16
5	Modele përdorimi <i>Utility Models</i>	4	1
6	Ripërtëritje patente <i>Patent renewals</i>	2726	2628
7	Ndryshime në patentë <i>Patent Changes</i>	110	132

Tabela më poshtë tregon akte të tjera të lëshuara nga sektori i patentave gjatë vitit 2016.

The table below shows other acts issued by the patent sector during 2016.

1	Patenta të skaduara <i>Patent Lapses</i>	453
2	Aplikime për patenta të refuzuara <i>Application for patent rejected</i>	10
3	Njoftime gjatë procesit të ekzaminimit <i>Examination process notifications</i>	332
4	Korrigjime të gabimeve <i>Corrections</i>	4
5	Ekstrakte nga regjistri i patentave <i>Extract from patent register</i>	4
	Hetime për patentat <i>Searches for patents</i>	17

Patenta të shpikësve shqiptarë me përdorim edhe jashtë kufijve shqiptarë

Bazuar në bazën elektronike të të dhënave të DPPM, në total janë lëshuar **71** patenta kombëtare për shpikje, nga të cilat aktualisht në fuqi janë **45** të tilla. Janë skaduar për mospagesën e ripërtëritjes vjetore **20** patenta dhe **6** janë braktisur pronari i patentës.

Aplikimet për regjistrimin e shpikjeve në DPPM vijnë kryesisht nga individë. Nuk kemi aplikime nga univeritetet vendase apo institucione të tjera kërkimore. Dy vitet e fundit kemi pasur rritje të aplikimeve nga studentët dhe pensionistët si pasojë e uljes së tarifës së aplikimit për këtë kategori. Vitin e kaluar kishim 4 aplikime nga studentët dhe 2 aplikime nga pensionistët.

Për t'u ardhur në ndihmë aplikanteve shqiptarë, DPPM ka filluar procedurat për nënshkrimin e një marrëveshje me ZEP për të ulur me 75% tarifën e ekzaminimit për shtetasit shqiptar.

Gjatë 10 viteve të fundit, DPPM ka shërbyer si zyrë pritëse për dërgimin e 6 shpikjeve vendase në OBPI si aplikim bazuar në Traktatin për Bashkëpunim mbi Patentat.

Një nga këto është patenta kombëtare me numër regjistrimi 4549 e shpikësit Dashamir Elezi, i cili ka kërkuar edhe shtrirje të regjistrimit në SHBA.

Kjo shpikje konsiston në një dopio pirun të dhëmbëzuar i cili gjen përdorim në fushën gastronomike dhe specifikisht në restoracionin modern në të cilin Maitre (Shefi i salles) kryen përfundimin e përgatitjes së një gatimi në prezencë ose përballë klientit në ambientin e sallës. Gjithashtu kjo shpikje gjen përdorimin e saj edhe në bankot e ndryshme të gastronomisë në lidhje me ushqimin e shpejtë (fast food, take way etj).

Bazuar në statistikën e ZEP, rezulton se janë depozituar në këtë zyrë 11 aplikime për patenta nga aplikantë rezidentë në Shqipëri, në 10 vitet e fundit.

Llojet e patentave për të cilat është aplikuar nga shqiptarët në vitin 2016.

Në vitin 2016 në DPPM janë aplikuar 23 aplikime për patenta mbi shpikjet dhe 4 për modele përdorimi. Të gjitha aplikimet janë depozituar nga individë, nga të cilët 4 janë studentë dhe 2 pensionistë. Aplikimet janë në fazë ekzaminimi. Pas 18 muajve ato bëhen publike në buletin e DPPM.

Patents for Albanian inventions also used outside Albanian borders

Based on the electronic data base of the GDPT, in total, **71** national patents for inventions were issued, of which **45** are currently in force. For non-payment of the annual renewal, **20** patents have expired, and **six** were abandoned by their owner.

Applications for the registration of payments come mainly to the GDPT from individuals. We do not have applications from local universities or other institutions. In the past two years, we have had an increase of applications from students and pensioners, as a consequence of the reduction of the tariff for applying to these categories. Last year, there were four applications from students and two applications from pensioners.

In order to assist Albanian applicants, the GDPT has begun procedures for signing an agreement with the EPO to reduce the tariff for examination for Albanian citizens by 75%.

During the last 10 years, the GDPT has served as the receiving office for sending six local inventions to WIPO as applications based on the Patent Cooperation Treaty.

One of those is the national patent with registration number 4549 of inventor Dashamir Elezi, who also sought the extension of registration to the USE.

This invention consists of a double toothed fork that is used in the field of gastronomy, and specifically, in modern restoration in which the Maitre d' (Chef of the dining room) performs the conclusion of a food preparation in the presence of or opposite the client in the premises of the dining room. In addition, this invention is also used in various gastronomic facilities in connection with fast food, take-away and so forth.

Based on EPO statistics, it turns out that 11 applications were deposited in this office for patents from Albanian residents in the last 10 years.

Types of patents applied for by Albanians in 2016.

In 2016 the GDPT received 23 applications for patents on inventions and four for utility models. All the applications were deposited by individuals, of which four were students and two were pensioners. The applications are in the examination phase. After 18 months, they are made public in the bulletin of the GDPT.

Fusha e zbatimit të këtyre shpikjeve është si më poshtë:

Mekanike Mechanical	8
Elektronike/elektroteknike Electronics/electro-technology	12
Ndërtimi Constructions	3
Teknologji e naftës Oil Technology	1
Farmaceutike Pharmaceutical	1
Metalurgji Metallurgy	1
Teknologji Technology	1

Fusha e zbatimit të këtyre shpikjeve është si më poshtë:



MARKAT TREGTARE

VI. MARKAT TREGTARE

Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë ose kombinim shenjash, që shërben për të dalluar origjinën tregtare të mallrave apo shërbimeve që ndodhen në treg. (fjalët, emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtime, figurat vizatimet si dhe format e mallrave). Marka duhet të ketë karakter dallues. Funkzioni i saj kryesor është që të bëjë të mundur të dallohen mallrat dhe shërbimet e një kompanie nga një tjetër. Ky quhet funksioni për garancinë, garanci për konsumatorin në lidhje me cilësinë e produkteve. Marka është e lidhur shumë me mallrat mbi të cilat vendoset ose me marketingun që u bëhet atyre. P.sh. marka mund të vendoset jo vetëm mbi vetë mallrat, por edhe në kontenierin për transport apo në stendat e shitjes, në reklamat ose në dritaret e dyqaneve ku ato shiten. Marka duhet të jetë tërheqëse për konsumatorin, t'i transmetojë atij idenë e cilësisë, sigurisë dhe besimit. Ky quhet funksioni joshjes i markës.

Ka dy rrugë nëpërmjet të cilave mund të kryhet aplikimi për regjistrim markash në DPPM.

- 1-Aplikime në rrugë kombëtare nga subjekte shqiptare dhe të huaja;
- 2- Aplikime ndërkombëtare nëpërmjet Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit. (Sistemi i Madridit)

Aplikime kombëtare për regjistrim markash.

Gjatë vitit 2016, DPPM ka pritur **1055** aplikime për marka, në krahasim me **937** aplikime të vitit 2015, duke shënuar një rritje me **12.6%** të aplikimeve për marka. Nga këto aplikime janë ekzaminuar **924** aplikime ose **87.6%** e tyre dhe për **350** aplikime janë lëshuar certifikatat e regjistrimit.

VI. TRADEMARKS

Trademarks can be any sign or combination of signs that serves to distinguish the commercial origin of goods or services that are found in the marketplace (words, personal names, letters, number, abbreviations, drawings as well as forms of goods). The mark should have a distinctive nature. Its main function is to make it possible for the goods and services of a company to be distinguished from another.

A trademark is closely linked to the goods on which it is put or the marketing made of the goods. For example, the trademark may be put not only on the goods themselves, but also on the transport container or the points of sale, in advertisements or the windows of stores where they are sold. The trademark should attract the consumer and transmit to him the idea of quality, security and trust. This is called the enticing function of the trademark.

There are two ways in which an application for registration of trademarks may be made to the GDPT.


- 1-Applications in the national route for Albanian and foreign subjects;
- 2- International applications through the Madrid Agreement and Protocol (Madrid System)

National applications for registration of marks

During 2016, the GDPT received **1055** applications for trademarks compared to **937** applications in 2015, showing an increase of **12.6%** of applications for trademarks. Of those applications, **924** applications, or **87.6%** of them, were examined, and certificates of registration were issued for **350** applications.

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve kombëtare për regjistrim marke në DPPM, 2010-2016.

The following graph shows the number of national applications for registration of trademarks in the GDPT, 2010-2016



Gjatë vitit 2016 rritje ka patur numri i aplikimeve kombëtare nga subjekte shqiptare, të cilat arritën në 662 duke u rritur me 30% krahasuar me vitin paraardhës.

Numri i aplikimeve nga subjekte shqiptare është pothuajse trefishuar në krahasim me vitin 2010.

During 2016 there was an increase in the number of national applications from Albanian subjects, which reached 662, a 30% increase over the prior year. The number of applications

from Albanian subjects almost tripled, in comparison with 2010.

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve kombëtare nga subjekte shqiptare për regjistrimin e markës në DPPM, 2010-2016.

The following graph shows the number of national applications from Albanian subjects for registration of trademarks in the GDPT, 2010-2016.




Tabela më poshtë tregon disa nga markat mbi produktet "made in Albania" të regjistruara ose që kanë aplikuar për regjistrim në DPPM.

The following table shows some of the trademarks for products "made in Albania" registered or applied for registration in the GDPT.

Nr. No	Emri i aplikantit/pronarit Name of applicant/owner	Emërtimi i markës Mark name	Statusi i markës/ (Viti i regjistrimit/aplikimit) Status of the mark (Year of registration or application)	Lloji i produktit Type of product
1	Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Sha	SKENDERBEU/ Gjergj Kastrioti Skënderbeu	Të regjistruara (2016) Registered (2016)	Pije alkoolike (brandy, raki) Alcoholic beverage (brandy, raki)
2	Petrit Çobo	Çobo	Në fazë aplikimi (2016) In the application phase (2016)	Verë Wine
3	Gjirofarma sh.a	GJIROFARM	Të regjistruara (2006) Registered (2006)	Prodhime qumeshti, djath, kackavall. Milk products, cheese.
4	AGNA ShA	Ambla	Në fazë publikimi (2016) In Publication phase(2016)	Qumësht Milk
5	EUGEN SKERMO	MJALTE MORAVA	E regjistruar (2013) Registered (2013)	Mjalt Honey

6	FRYMA E KELMENDIT	Mishavinë	E regjistruar (2016) Registered (2016)	Prodhome qumështi, djath. Milk products, cheese.
7	LAJTHIZA INVEST SH.A	LAJTHIZA	E regjistruar (2014) Registered (2014)	Ujë mineral dhe i gazuar Mineral water, sparkling water
8	Led Manushi	Kantina Manushi	E regjistruar (2016) Registered (2016)	Verë Wine
9	KLEGEN	KLEGEN	Në pritje të pagesës për certifikate (2016) Awaiting payment for the certificate (2016)	Qumësht dhe nënprodukte qumështi Milk and milk products
10	Edit Bllaca	Ed Bllaca	Në fazë publikimi (2016) In the publication phase (2016)	Akullore; Kasata Ice cream; ice cream cones
11	Irsjola shpk	Pastiçeri Gelateri Çela	Në fazë publikimi (2016) In the publication phase (2016)	Produkte pastiçerie Confectionary products
12	Arseni shpk	Tropikal	E regjistruar (2015-2016) Registered (2015-2016)	Lëngje frutash Fruit juices
13	Pastiçeri Lika shpk	Pastiçeri Lika	E regjistruar (2016) Registered (2016)	Produkte pastiçerie Confectionary products
14	LUFRA - Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar	LUFRA	E regjistruar (2013) Registered (2013)	Qumësht dhe nënprodukte qumështi Milk and milk by-products
15	ERZENI - Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	ERZENI	E regjistruar (2013) Registered (2013)	Qumësht dhe nënprodukte qumështi Milk and milk by-products
16	SOAL - Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	SOAL	E regjistruar (2013) Registered (2013)	Qumësht dhe nënprodukte qumështi Milk and milk by-products
17	HAKO shpk	Hako	E regjistruar (2008) Registered (2008)	Sallame dhe proshuta Salami and ham
18	EHV shpk	EHV	E regjistruar (2010) Registered (2010)	Produkte dhe nënprodukte mishi (sallamra) Meat and meat by-products (sausage of various kinds)
19	TONA CO	TONA	E regjistruar(2013) Registered (2013)	Produkte dhe nenprodukte mishi Meat and meat by-products
20	MULLIRI ARTE	MULLIRI ARTE	E regjistruar (2013) Registered (2013)	Miell Flour
21	UJI I FTOHTE TEPELENE Sh.p.k.	TEPELENE	E regjistruar (2012) Registered (2012)	Ujera minerale dhe te gazuar Mineral water and sparkling water
22	TEUTA SH.P.K.	FASULE GOLD	E regjistruar (2008) Registered (2008)	Fasule Beans
23	Manula Kotini	Manu	Në fazë aplikimi (2016) In the application phase (2016)	Veshje Clothing

Aplikime për regjistrim markash nga sistemi Madridit.


Nga marrëveshja dhe protokoli i Madridit janë depozituar **2400** aplikime në vitin 2016 duke u ulur me **6%** krahasuar me vitin 2015.

Grafiku tregon numrin e aplikimeve për regjistrim marke në Shqipëri nga sistemi i Madridit 2010-2016.

Applications for registration of trademarks from the Madrid system

*In 2016, **2400** applications from the Madrid Agreement and Protocol were deposited, a reduction of **6%** in comparison with 2015.*

The graph below shows the number of trademark applications for registration in Albania from the Madrid system 2010-2016.



Grafiku tregon aplikimet nga sistemi i Madridit, ku DPPM ka shërbyer si zyrë origjinës dhe si zyrë e zgjedhur nga të huajt për regjistrimin e markave 2015-2016.

The graph below shows the applications from the Madrid System where the GDPT served as the office of origin and the office chosen by foreigners for trademark registration 2015-2016.

Aplikime nga Sistemi i Madridit /Application from Madrid System	2015	2016
Shqipëria si zyrë e origjinës / Albania as office of origin	6	7
Shqipëria si zyrë e zgjedhur / Albania as designated contracting party	2555	2400

Subjektet shqiptare kanë zgjeruar aktivitetin e tyre edhe në tregjet e huaja duke kërkuar edhe mbrojtje ndërkombëtare të markave të tyre.

Albanian subjects have also extended their activity to foreign markets, seeking international protection of their trademarks.

Më poshtë gjeni një listë me markat shqiptare që kanë shtrirje ndërkombëtare të mbrojtjes.

Below you will find a list of Albanian trademarks that have an international protection extension


Tropikal Mela verde	AL	16.07.2012	
Butterfly	AL	09.08.2012	
Ercole Marelli Power Sh.A.	AL	18.09.2013	
ama il mio amato caffè	AL	23.10.2013	
kraco	AL	27.11.2013	
il cammino	AL	22.01.2014	
ama CAPSULE	AL	13.03.2014	
DUMDUM ENERGY DRINK	AL	24.03.2014	
B-2 INDIAN TONIC WATER THE DRY ONE	AL	08.07.2014	
H10	AL	19.06.2014	
ama	AL	17.09.2014	
ENERGY KING LUXURY ENERGY DRINK	AL	20.05.2015	
Mr. Café	AL	29.04.2015	
ELKA Daily COCOA SPREAD WITH HAZEL-NUTS	AL	03.06.2015	
GJERGJ KASTRIOTI Skenderbeu brandy	AL	27.08.2015	
Sheldia	AL	03.06.2015	
B-2 ENERGY DRINK	AL	09.06.2016	
BELINO	AL	21.01.2016	
Croissant Replay ELKA	AL	21.01.2016	
BLACK MOUNT Full Flavour FINEST VIRGIN-IA FILTER CIGARETTES	AL	03.11.2016	
GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU	AL	28.04.2005	
PENELOPE	AL	07.06.2007	
natyral	AL	29.04.2008	

Vlen të theksojmë se rritje ka pasur edhe numri i aplikimeve për regjistrim ndërkombëtar të markave nga subjektet shqiptare, si pasojë e ndërgjegjësimit të biznesit dhe zgjerimit të tyre përtej kufijve shqiptarë. Nga 6 aplikime në vitin 2015, në vitin 2016 janë dërguar 7 aplikime për regjistrim ndërkombëtar.

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve në total në % për vitin 2016.

It merits mention that there has also been an increase in the number of applications for international registration of trademarks by Albanian subjects as a consequence of the sensitising business and their expansion beyond Albanian borders. From six applications in 2015, seven applications were sent for international registration in 2016.

The chart below shows the total number of applications in % for 2016.



Vërejmë se aplikimet ndërkombëtare zënë 70%, aplikimet kombëtare nga aplikantë shqiptarë zënë 19% dhe aplikimet nga subjektet e huaja zënë 11%. Numri i aplikimeve nga subjekte shqiptare është rritur në vitin 2016 dhe në totalin e numrit të aplikimeve ato zënë 19% në krahasim me 11% që zënë aplikimet nga subjekte të huaja.

We note that international applications make up 70%, national applications from Albania applicants 19% and applications from foreign subjects 11%. The number of applications from Albanian subjects has increased in 2016 and make up 19% of the total number of applications, compared to 11% made up applications from foreign subjects.

Aplikimet për Ripërtëritje të Markave.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve për ripërtëritjen e markave për vitet 2015 dhe 2016.

Applications for renewal of trademarks

The following graph and table shows the number of applications for the renewal of trademarks for the years 2015 and 2016.

Aplikime për ripërtëritje Renewal requests	Viti 2015 Year 2015	Viti 2016 Year 2016	% e rritjes % of increase
Aplikime për ripërtëritje markash kombëtare Request for renewal of trademarks in national route	614	626	2%
Aplikime për ripërtëritje markash ndërkombëtare Requests for renewal of international trademarks from Madrid System	1807	2217	22.7%
TOTALI Total	2421	2843	17.4%

Në vitin 2016 janë lëshuar gjithësej **678** certifikata ripërtëritje.

In 2016, in all, **678** renewal certificates were issued.

Regjistrime të Aplikimeve për Regjistrim Markash.

Sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë gjatë vitit 2016 ka lëshuar **1054** certifikata regjistrimi, në krahasim me 763 të lëshuara në vitin 2015, duke u rritur me 38.1% numrin e tyre. Gjithashtu gjatë këtij viti ky sektor ka lëshuar **7216** akte administrative krahasuar me **4111** akte të lëshuara një vit më parë.


Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Marka të regjistruara në rrugë kombëtare <i>Trademarks registered in national route</i>	721	563	498	763	1054

Registrations of applications to register trademarks.

The sector of examination of trademarks, industrial designs and geographic indicators issued **1054** certificates of registration during 2016, compared to **763** issued in 2015, an increase of **38.1%** of their number. In addition, during this year the sector issued **7216** administrative acts, compared to **4111** acts issued a year ago.


Grafiku tregon numrin e certifikatave të regjistrimit dhe ripërtëritjes të lëshuara në vitet 2015 dhe 2016:

The following graph shows the number of certificates of registration and renewal issued in the years 2015 and 2016:



Ndërsa grafiku i mëposhtëm tregon raportin ndërmjet aplikimeve dhe regjistrimeve të markave në DPPM.

On the other hand, the following graph shows the relationship between trademark applications and registrations in the GDPT.



Nga tabelat e mësipërme shihet qartë se volumi i punës i përbulluar këtë vit nga DPPM është shumë më i madh se ai i dy apo tre viteve më parë.

Aktualisht janë **22** marka shqiptare të cilat kanë regjistrim ndërkombëtar nga **34** aplikime të bëra gjithsej për regjistrim ndërkombëtar, të tjerat janë në pritje për tu regjistruar.

From the tables above, it can clearly be seen that the volume of work met with in this year by the GDPT is much greater than that of the prior three years.

Currently, there are **22** Albanian trademarks that have an international registration, of **34** applications made in all for international registration, which are waiting to be registered.

Bizneset vendase të cilat kanë të regjistruara marka në DPPM nuk kanë asnjë aplikim për patentë apo patentë të regjistruar.

Për cilat mallra dhe shërbime sipas klasifikimit të Nicës, është numri më i madh i aplikimeve për marka në vitin 2016?

Numrin më të madh e zënë produktet farmaceutike të përfshira në **klasën 5**, e ndjekur nga produktet ushqimore **klasa 30**, shërbimet e shitjes, reklamës, administrim biznesi, etj **klasa 35** dhe shërbimet e edukimit, argëtimit klasa **41**.


Grafiku tregon përqindjen sipas klasave të produkteve të mbrojtura nga markat e regjistruara në 2016.

Local businesses that have registered trademarks in the GDPT do not have any application for patents or patents registered.

For which goods and services, according to the Nice classification, is the number of trademarks in 2016 the greatest?

The greatest number is taken up by pharmaceutical products included in **class 5**, followed by food products, **class 30**, services of selling, advertising, business administration, and so forth, **class 35**, and educational and entertainment services, **class 41**.

The chart below shows the percentage, by classes, of the products protected by trademarks registered in 2016




Nëse do të bënim një krahasim me vitin 2015 për markat e regjistruara nëpërmjet sistemit të Madridit vërejmë se aplikimet për regjistrim marke përgjithësisht janë bërë për të njëjtat produkte apo shërbime, përveç klasës 9 për të cilën është aplikuar më shumë në vitin 2015.

Grafiku i klasave të markave të regjistruara sipas sistemit të Madridit, 2015:

If we were to make a comparison with 2015 about trademarks registered through the Madrid system, we see that applications for the registration of marks were generally made for the same products or services, in addition to class 9 for which there were more applications in 2015.

Chart of the classes of trademarks registered according to the Madrid system, 2015:



Kompanitë shqiptare që kanë më shumë aplikime për regjistrim markash në vitin 2016:

Albanian companies with the most applications for registration of trademarks in 2016:

Nr.	EMRI I APLIKANTIT NAME OF APPLICANT	Numri i aplikimeve për marka nga subjekte shqiptare në vitin 2016 Number of applications for trademarks by Albanian subjects in 2016
1	ELAL COM	56
2	RM sh.p.k	43
3	PROFARMA	12
4	EUROPRINTY GROUP SHPK	12
5	B.B.F Company SH.P.K	10
6	TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A	8
7	Petrit Cobo	7
8	FONDACIONI GULISTAN	7
9	EPOA GROUP, AgroAL	7
10	"ELECTRAL" SHPK	7

Number of applications according to country of origin of the owner.

Number of applications according to country of origin of the owner.

SHTETI CONTRY	Numri i aplikimeve për marka sipas vendit të origjinës së aplikantit, viti 2016 Number of applications for trademarks by country of origin, 2016
SHIPËRI ALBANIA	662
SHBA USA	100
TURQI TURKEY	44
SERBI SERBIA	27
ZVICËR SWITZERLAND	22

Dokumentat e lëshuara mbi aplikimet për marka.


Siç e përmendëm edhe më sipër nga sektori i markave gjatë këtij viti janë lëshuar 7216 akte administrative nga të cilat: 1054 çertifikata regjistrimi, 678 çertifikata regjistrimi ripërtëritje, 120 refuzime për moskryerje pagesë regjistrimi, refuzime nga ekzaminimi formal dhe refuzime për shkaqe absolute, pjesa tjetër prej 5364 dokumentash janë lëshuar për aplikime në proces ekzaminimi.

Grafiku i mëposhtëm tregon një pjesë të dokumentave të lëshuara gjatë procesit të ekzaminimit.

Documents issued on applications for trademarks

As also mentioned above, during this year the sector of trademarks issued 7216 administrative acts, among which 1054 were registration certificates, 678 renewal registration certificates, 120 refusals for failure to make registration payment, refusals from the formal examination and refusals for absolute causes, and another 5364 documents were issued in connection with applications in the process of examination.

The chart below shows documents issued during the examination process




Gjithashtu janë kryer veprimet për të gjitha kërkesat për lëshimin e ekstrakteve të regjistrimit të paraqitura në vitin 2016 dhe janë kryer të gjitha hetimet sipas kërkesave të depozituara nga aplikuesit për të gjitha objektet e Pronësisë Industriale, si dhe hetime e shkresa në përgjigje të institucioneve të përfshira në mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale si prokuroria, doganat, etj.

Grafiku i mëposhtëm tregon statusin e markave të depozituara në vitin 2016:

Actions were also carried out for all requests for the issuance of extracts from the register submitted in 2016 and all investigations were performed according to requests deposited by applicants for all objects of Industrial Property, as well as investigations and letters responding to institutions involved in the protection of IP objects such as the prosecutor's office, customs and others.

The following graph shows the status of marks deposited in 2016:





VII. DISENJOT INDUSTRIALE

Disenjoja industriale konsiston në pamjen e jashtme ornamentale dhe estetike të një produkti. Ky aspekt i pamjes së një produkti varet nga forma, detajet, apo ngjyrat e produktit. Disenjoja duhet të jetë tërheqëse dhe të performojë me efikasitet në mënyrë që t'i japë vlerë produktit dhe të krijojë lidhjen emocionale me konsumatorin.

Në një farë mënyre disenjot shprehin dhe identifikojnë shijet dhe cilësinë e jetës të përdoruesve të tyre. Në tregjet e sotme, njohuritë dhe teknologjitë përhapen me shpejtësi, konkurrenca shtohet, dhe produktet bëhen të vjetra pothuajse brenda natës.

Suksesi i takon atyre që janë kreativë dhe arrijnë të sjellin risi në mallrat që ofrojnë.

Gjatë vitit 2016 në DPPM janë depozituar **9 aplikime** për regjistrim disenjoje, ndërsa në vitin 2015 janë depozituar **5 aplikime**, pra kemi një rritje të numrit të aplikimeve me **80%**.


VII. INDUSTRIAL DESIGNS

An Industrial Design consists of the external ornamental and aesthetic appearance of a product. This aspect of the appearance of a product depends on the form, details or colour of the product. The design should be attractive and perform efficiently in such a way as to give value to the product and to create an emotional link with the consumer.

In a certain way, industrial designs also express and identify the quality of life of their users. In today's markets, information and technologies spread rapidly, competition grows and products become obsolete almost overnight.


Success belongs to those who are creative and succeed in bringing innovations in the goods they offer.

During 2016, **nine** applications for industrial designs were deposited in the GDPT, while in 2015 **five** such applications were deposited, that is, an increase of **80%** in the number of applications.




Nga 9 aplikimet për regjistrim disenjoje të depozituara në 2016, 5 janë bërë nga aplikantë shqiptarë

Of the nine applications for design registrations deposited in 2016, five were made by Albanian applicants.



Nga Marrëveshja e Hagës në vitin 2016 janë regjistruar **239** diseno industriale me **942** diseno të shumëfishta si dhe **98** ripërtëritje disenjoje dhe janë depozituar për regjistrim **276** diseno industriale me **1022** diseno të shumëfishta.

From the Hague Agreement, **239** industrial designs were registered in 2016, with **942** multiple designs as well as **98** renewals of designs, and **276** industrial design as with **1072** multiple signs were deposited for registration.





VIII. TREGUESIT GJEORAFIKË

Treguesit Gjeografikë janë objekt shumë i rëndësishëm i Pronësisë Industriale. Tregues gjeografik është emri i një vendi, lokaliteti ose rajoni që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësia, reputacioni dhe karakteristikat e të cilit janë atribut i kësaj origjine gjeografike. Shqipëria është një vend i pasur në biodiversitet falë kushteve të ndryshme klimaterike në zona të ndryshme të Shqipërisë. Të gjithëve na pëlqen të udhëtojmë për të vizituar Shqipërinë, sepse e dimë që përveç pamjeve të mrekullueshme panoramike, na ofrohen edhe produkte karakteristike të zonave ku ato janë prodhuar të cilat shpesh herë janë krejt unike në llojin e tyre. Këto produkte mund të jenë një resurs ekonomik i rëndësishëm dhe mbrojtja e tyre ndikon zhvillimin në zonat rurale, si dhenxit eksportin e produkteve shqiptare në tregun e huaj, duke i bërë ato të njohura në botë.

Në Projektligjin e ri për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, të ndryshuar është parashikuar në mënyrë të veçantë forcimi i bazës ligjore për mbrojtjen e treguesve gjeografikë në Shqipëri duke përcaktuar kriteret e sakta proceduriale për regjistrimin e këtyre produkteve.

Gjithashtu shumë i rëndësishëm është fakti që në Strategjinë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020, parashikohet anëtarësimi i Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës duke mundësuar regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë. Kjo marrëveshje bën më të lehtë regjistrimin e produkteve tipike shqiptare në vendet e huaja si dhe futjen e produkteve të huaja në tregun shqiptar të garantuara për llojin dhe cilësinë e tyre.

VIII. GEOGRAPHIC INDICATORS

Geographic indicators are a very important object of Industrial Property. A geographic indicator is the name of a country, locality or region that serves to define products that originate in that place, the reputation and characteristics of which are attributes of that geographic origin. Albania is a country rich in biodiversity thanks to various climatic conditions in different areas of Albania.

It pleases everyone to travel to visit Albania, because we know that in addition to marvellous panoramic views, characteristic products of areas where they are produced are offered to us, which often are quite unique in their type. Those products could be an important economic resource, and protecting them affects development in rural areas, as well as encouraging the export of Albanian products to the foreign market, making them known worldwide.

In the new draft law on additions and amendments to law no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property,” amended, the strengthening of the legal basis for the protection of geographic indicators in Albania has been specifically provided, defining precise procedural criteria for the registration of those products.

In addition, it is very important that in the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020 the membership of Albania in the Lisbon Agreement is foreseen, enabling the international registration of geographic indicators. This agreement makes it easier to register typical Albanian products in foreign markets as well as introducing foreign products to the Albanian market, guaranteed as to their type and quality.

Tabela e mëposhtme përmban disa nga produktet shqiptare për mbrojtje si tregues gjeografikë në DPPM.

The following table contains several of the Albanian products for protection as geographic indicators in the GDPT.

Nr. No.	Emri i aplikantit/pronarit Name of the applicant/ owner	Emri i Treguesit gjeografik Title of geographical indication	Statusi i Treguesit gjeografik (Viti i regjistrimit/aplikimit) Status of the Geographical Indication (Year of application/ registration)	Lloji i produktit Product
1	S.E.D. Borsh Sh.p.k.	BORSH Y.HAJDINI	I regjistruar (2006) Registered (2006)	Vaj ulliri Olive oil
2	Previzi Sh.p.k.	Vaj ulliri Saranda	I regjistruar (2013) Registered (2013)	Vaj ulliri Olive oil
3	Mustafaraj	Uji Vlora	I regjistruar (2013) Registered (2013)	Ujë I ambalazhuar Packaged water
4	Shoqata "Gruaja dibrane shpresa e së ardhmes"	Jufka Dibrane	I regjistruar (2015) Registered (2015)	Jufka Jufka (an egg-based dessert)
5	KOP.FRUT.DIBER 2012	Molla Dibrane	Në proces regjistrimi (2015) In registration process (2015)	Mollë Apple
6	Shoqata e Blegtorëve të Dhisë Hasi	Keci i Hasit	Në proces regjistrimi (2016) In registration process (2016)	Mish keci Meat of goat's kids (baby goats)
7	A-Korabi	Ujë Korabi	Në proces regjistrimi 2016 In registration process (2016)	Ujë I ambalazhuar Packaged water

Gjatë vitit 2016, në DPPM janë depozituar 2 kërkesa për regjistrim treguesish gjeografikë nga subjekte shqiptare. Njëri nga këto aplikime për tregues gjeografikë është “Keci i Hasit” ky aplikim është bërë nga një shoqatë dhe jo nga individ, me dokumenta dhe kriterë sipas kushteve të BE.

During 2016, two requests for the registration of geographic indicators were deposited in the GDPT by Albanian subjects. One of these applications for a geographic indicator was “baby goat of Has”, an application that was made by an association and not by an individual, with documents and criteria according to EU conditions and criteria.

“Keci i Hasit” AL/E/2016/1

“The baby goat of Has” AL/E/2016/1



Grupi: Shoqata e mbarështuesve të dhisë së Hasit. Grupi përbëhet nga fermerët që mbarështojnë dhinë e Hasit, një përpunues qumështi në fshatin Sahan dhe një veteriner lokal.

Adresa: Krumë, Has

Statusi Ligjor: Shoqata e mbarështuesve të dhisë së Hasit është regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendim Nr. 5242, datë 08.02.2016

Produkti: Mish i freskët i kecape.

Emri i Produktit: Keci i Hasit.

Përshkrimi i Produktit: Mishi i therur i kecape meshkuj e femra, me moshë në therje 3 deri në 6 muaj. Peshë e karkasave duhet të jetë ndërmjet 10 deri në 18 kg., Kakasa duhet të jetë e veshur me një shtresë të hollë dhjami me mbizotërim të ngjërës së bardhë krem. Mishi duhet të ketë ngjyrë të kuqërremtë të çelur, pa shumë dhjam. Ai nuk duhet të ketë erë të fortë karakteristike të dhive.

Territori (zona gjeografike): Kufijtë e territorit janë: Nga ana e lindjes kufizohet me kufirin shtetëror që kalon nga Liqeni i Firezës, në pikën kufitare të Qafë Morinit, në Lindje të qytetit të Kukësit, dhe vazhdon në drejtim të Veri-Lindjes deri ku ndahet kufiri me bashkinë e Tropojës, ndjek kufirin lindor të bashkisë në drejtim të jugut deri sa takon me liqenin e Fierzës, pastaj ndjek bregun e liqenit në drejtim të jugut. Kjo zonë ka disa specifika që lidhen me sistemin e hurdhave, dhe të gjitha praktikat kullimore përcaktohen nga ai. Lidhja e produktit me territorin mbështetet kryesisht në një traditë qindrvjeçare të mbajtjes së dhive në këtë territor si dhe në shfrytëzimin e sistemit kullor të pllajës karstike. Të gjitha fermat e përfshira në këtë territor kanë të përbashkët pikërisht shfrytëzimin e sistemit kullor të pllajës karstike.

Njësitë administrative: Prodhim i kecape bëhet në fermat e fshatrave Gjinaj, Domaj, Pusi i Thatë, Cahan, Kishaj, Mujaj, Vlahen, Golaj, Vranisht, Dobrunë, Nikoliq, Letaj, Tregtan.

Origjina e Kafshëve (prova e origjinës): Tufat janë të përbëra nga kafshë të cilat plotësojnë specifikimet e produktit me origjinën gjeografike. Kafshët e përshtatshme, shënohen me një matrikull në vesh, përpara daljes së tyre të parë në kullotë. Çdo fermer mban një regjistër i njohur si inventari i kafshëve të përshtatshme për GI. Kafshët që plotësojnë kushtet që merren nga tufa për tu therur, duhet të shoqërohen nga një shënim largimi të plotësuar nga fermeri. Thërrëret duhet të mbajnë një regjistër për hyrjet dhe daljet e çdo kafshe për të mundësuar identifikimin e origjinës dhe destinacionit të kafshëve. Këto regjistra vihen në dispozicion të inspektorit të autorizuar.

Kërkesat që plotësojnë kushtet për markën e cilësisë etiketohen me etiketën (vulën) dhe logon përkatëse. Keca të prejardhur nga dhinë e racës së Hasit sipas karakteristikave të përshkruara në aneks. Të lindura në tufat e dhive në territorin e përcaktuar. Të përfuara nga

Group: An association of goat breeders of Has. The group consists of farmers who breed goats in Has, a processor of milk in the village of Sahan and a local veterinarian.

Address: Kruma, Has

Legal status: The association of goat breeders of Has is registered in the court of Tirana by decision no. 5242 dated 08.02.2016

Product: Fresh meat of baby goats (kids).

Name of product: Baby goat of Has.

Description of product: Cut meat of baby goats, masculine and feminine, with an age at time of slaughter of three to six months. The weight of the carcasses should be between 10 and 18 kg. The carcass should be dressed with a thin layer of fat, predominantly the colour of white cream. The meat should have a bright reddish colour, without much fat. It should not have a strong smell, characteristic of goats.

Territory (geographic area): The boundaries of the territory are: On the east, it is bordered by the state border that passes by the lake of Fierza, at the border point of Morina pass (qafa Morinë); on the east of the city of Kukës, and continuing in a north-east direction, up to the border line with the municipality of Tropoja; it follows the eastern boundary of the municipality in a southerly direction, until it meets lake Fierza; then it follows the eastern bank of the lake in a southerly direction. This area has several specifics that are related to the system of marshes, and all the pasturage practices are defined by it. The relation of the product with the territory mainly relies on a centuries-old tradition of keeping goats in this territory as well as exploiting the pasturage system of a plateau of karst. All the farms in this territory have in common the use of the pasturage system of that karstic plateau.

Administrative unit: The baby goats are produced in the farms of the villages of Gjinaj, Domaj, Pusi i Thatë, Cahan, Kishaj, Mujaj, Vlahen, Golaj, Vranisht, Dobrunë, Nikoliq, Letaj and Tregtan.

Origin of the animals (proof of origin): The flocks consist of animals that meet the specifications of the product with the geographic origin. The appropriate animals are marked with an identification tag on their ear, before they go out to pasture. Every farmer keeps a register known as the inventory of animals appropriate animals for the geographic indicator (GI). Animals that meet the conditions who are taken from the flock to be slaughtered should be accompanied by a notation that they have left, filled out by the farmer. The slaughterhouses should keep a register of the entry and leaving of every animal in order to enable the identification of the origin and destination of the animals. Those registers are made available to the authorised inspector.

Carcasses that meet the conditions for the quality mark are labeled (with a seal) and the respective logo as baby goats coming from the race of Has, according to the characteristics described in an annex, born in the flocks of goats in the defined territory, obtained

çiftëzimet me cjep të racës së Hasit (pjesë e programit racor), të certifikuar nga shoqata e blegtorëve të dhisë Hasi.

Metoda e prodhimit: Kullotja duhet të jetë element dominues i mënyrës së mbajtjes. Dhitë duhet të nxirren në kullotë të paktën 310 ditë në vit. Kullotja në dushk duhet të jetë pjesë e rëndësishme e mbarështimit të dhive. Të gjitha dhitë duhet të shfrytëzojnë për kullotje pllajën karstike. Gjatë periudhës së dimrit mund të ushqehen në stallë, por përdorimi i kullotës është shumë i rekomandueshëm. Kohëzgjatja maksimale e mbajtjes vetëm në stallë nuk duhet të kalojë 60 ditë. Ushqimi i dimrit duhet të jetë prodhuar në territorin e përcaktuar. Jo më pak se 50% e ushqimit të thatë duhet të jetë gjethe dushku. Koncentratet e përdorura për dhitë nuk duhet të përmbajnë proteinë shtazore. Strehimi i kafshëve mund të realizohet në mjedise tradicionale apo bashkëkohore, por çdo rast duhet të respektojë kushtet e mirëqenies së kafshëve të fermës.

from breeding of male goats of the race of Has (part of the racial program), certified by the association of pastoralists of the goats of Has.

Method of production: The pasturage should be the dominating element of the manner of maintenance. The goats should be taken out to pasture at least 310 days a year. Pasturage in areas of oaks should be an important part of breeding of the goats. All the goats should use the karst plateau for their pastures. During the winter period, they may be fed in stables, but the use of the pasture is highly recommended. The maximum time for keeping them only in a stable should not exceed 60 days. The winter food should be produced in the defined territory. No less than 50% of the dry food should be oak leaves. The concentrates used for the goats should not contain animal proteins. The animals may be housed in traditional or modern premises, but every case should respect the conditions of the welfare of the farm animals.



IX. BORDI APELIMIT

Bordi i Apelimit është një strukturë e brendshme e DPPM, që krijohet me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm dhe e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.

Ky organ i DPPM shqyrton kërkesat për kundërshtim të regjistrimit të objekteve të Pronësisë Industriale në DPPM. Konfliktet që lindin mbi të drejtat e objekteve të Pronësisë Industriale janë të pranishme, për këtë qëllim DPPM publikon në mënyrë periodike buletinët me të dhëna mbi aplikimet që janë depozituar për regjistrim. Në këtë mënyrë çdo person që konstaton se këto aplikime bien ndesh me të drejtat e tij të mëparshme mundet që brenda tre muajve nga data e publikimit të buletinit përkatës të depozitojë një kërkesë për kundërshtim, si një mundësi mjaft efikase për zgjidhjen e konfliktit në rrugë administrative pranë Bordit të Apelimit.

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të saj. Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE është në fokusin e veprimtarisë së DPPM.

Si kryhet kundërshtimi ndaj një marke?

Bazuar në Ligjin 9947, date 07/07/2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, të gjitha aplikimet për regjistrim të markave tregtare në DPPM publikohen çdo muaj në buletin e markave në faqen zyrtare të DPPM. Qëllimi i këtij publikimi është që çdo person që gëzon një të drejtë të mëparshme mbi një markë tregtare të mund të kundërshtojë regjistrimin e atyre markave që ai i konsideron të njëjta apo të ngjashme me markën e tij, për mallra dhe shërbime të njëjta dhe të ngjashme. Kundërshtimi ndaj një marke të publikuar, depozitohet në DPPM brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, kundërshtuesi pagesës së tarifës përkatëse.

IX. BOARD OF APPEAL

The Board of Appeal is an internal structure of the GDPT, created by internal order of the Director General and which exercises its activity in compliance with the provisions of law no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property” and the subordinate legal acts issued in implementation of it.

This organ of the GDPT examines oppositions to the registration of Industrial Property objects in the GDPT. Conflicts that arise about rights to IP objects are acceptable, and for this purpose the GDPT publishes periodically bulletins with data about applications that have been deposited for registration. In this way, any person who observes that those applications conflict with his prior rights may, within three months from the date of publication of the respective bulletin, lodge a request for an opposition, as a very effective possibility for resolving the conflict administratively at the Board of Appeal.

The protection of rights to objects of Industrial Property is one of its most important aspects. The continuous improvement of the legal basis for the purpose of approximation with EU legislation and standards is in the focus of activity of the GDPT.

How is an opposition made against a trademark?

Based on law no. 9947 dated 07.07.2008 “On industrial property”, amended, all applications for registration of trademarks in the GDPT are published every month in the bulletin of trademarks on the official page of the GDPT. The purpose of this publication is for every person who has a prior right to a trademark to be able to object to the registration of those marks that he considers the same as or similar to his trademark for goods and services that are the same or similar. An opposition to a published trademark is deposited in the GDPT within a three month period from the date of publication, against payment of the respective tariff.

Të drejtën për të kundërshtuar regjistrimin e një marke e gëzon:

- Personi që ka një të drejtë marke të mëparshme e cila fitohet nëpërmjet një date prioriteti ose date aplikimi për markë të mëparshme të depozituar në DPPM;
- Pronari i një marke të mëparshme, regjistruar në përputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 të nenit 143 të këtij ligji.
- Personi që ka të drejtën e një emri tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;
- Personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;
- Personi që gëzon të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;
- Personi që gëzon të drejtat e autorit të një veprë ose të një pjesë të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.
- Pronari i një marke e cila është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit.

Kundërshtimi mund të bëhet vetëm brenda afatit tre mujor të publikimit. Nëse personi që dëshiron të kundërshtojë nuk arrin të respektojë këtë afat atëherë ai duhet t'i drejtohet gjykatës.

Shqyrtimi i kundërshtimit

Bordi i apelimit i DPPM shqyrton nëse kundërshtimi i depozituar është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të këtij ligji. Çdo palë ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e kundërshtimit, si dhe të paraqesë argumentet e veta, me gojë ose me shkrim, brenda një periudhe kohore, të caktuar nga bordi i apelimit.

Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë të kërkojë palëve të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe, të parashikuar, për këtë qëllim, në rregulloren, dalë në zbatim të këtij vendimi.

Bordi i apelimit shqyrton kundërshtimin, brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes të të gjitha argumenteve, materialeve dhe dokumenteve shtesë nga palët dhe i njofton ato për vendimin e marrë.

Vendimi i bordit të apelimit mund të apelohe në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bordit.

The right to oppose the registration of a trademark is enjoyed by:

- A person who has the right to the prior mark which is gained through a priority date or date of application for a prior mark deposited in the GDPT;
- The owner of a prior mark registered in conformity with the provisions of points 1 and 2 of article 143 of this law;
- A person who has the right to a commercial name, provided that this name or the fundamental part of it shall be the same as or similar to the trademark that is sought to be registered, and the owner of the commercial name shall produce or obtain, respectively, goods or services that are the same as or similar to those of the trademark sought to be registered;
- A person whose name, surname or external appearance is the same as or similar to the trademark that is sought to be registered;
- A person who enjoys the rights of industrial property, including the names of protected plant or animal varieties and geographic indicators;
- A person who enjoys copyright in a work or part of it, provided that it shall be the same as or similar to the mark that is sought to be protected;
- The owner of a mark that is well-known in the Republic of Albania, in the meaning of article 6 bis of the Paris Convention, to the public of the respective sector, as a result of use, representation, publication or advertising.

An opposition may be brought administratively only within three months of publication; if the person who wants to oppose a registration does not manage to respect this time period, he has to turn to the court.

Examination of an opposition

The Board of Appeal of the GDPT examines whether the opposition deposited is in conformity with the requirements of point 1 of article 152 of this law. Any party has the right to take part in the opposition procedure or to present arguments, orally or in writing, within a time period set by the Board of Appeal.

During the examination, the Board of Appeal has the right to ask the parties to submit materials and other additional documents within a period provided for this purpose in the rules issued in implementation of this decision.

The Board of Appeal examines the opposition within a three-month time period from the date of submission of all the arguments, materials and additional documents by the parties and notifies them of the decision taken.

The decision of the Board of Appeal can be appealed to court within 30 days from the date the Board's decision is made known.

Në ndryshimet e reja ligjore është parë e rëndësishme dhe ndryshimi dhe funksionimi i Bordit të Apelimit, i cili nga një strukturë me 3 punonjës të DPPM, do të ndryshojë si një strukturë me anëtarë që vijnë nga vetë DPPM dhe me anëtarë (eksperte) që seleksionohen jashtë DPPM. Duke qenë të gjithë specialistë të fushës, do ta kthejnë këtë Bord në një organ më të specializuar dhe më të pavarur për marrjen e vendimeve, duke ndikuar në profesionalizmin dhe paanshmërinë e dhënies së vendimeve, si dhe duke ulur ndjeshëm rastet që kundërshtohen në gjykatë.

Mekëto rregullime që i bëhen Bordit të Apelimit, do të lehtësohet shumë puna e Gjykatës Administrative. Sigurisht që Gjykata Administrative do të ketë një rol të rëndësishëm pasi do të verifikojë dhe vlerësojë vlefshmërinë e vendimeve të Bordit të Apelimit, mbi bazën e ankimit të personave të interesuar kundër vendimeve të tij.

Gjatë vitit 2016 Bordi i Apelimit ka marrë vendim për 48 çështje mbi kundërshtimin e markave duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **28** raste:
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës në **13** raste
- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në **3** raste.
- pushimin e shqyrtimit për shkak të dorëheqjes nga marka ose nga kërkesa për kundërshtim, në **4** raste.

12 prej vendimeve të Bordit janë ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 janë apeluar pranë Bordit të Apelimit, **7** marka të refuzuara nga Drejtoria e Ekzaminimit.

- në **2** raste është pranuar kërkesa e apelimit dhe është vazhduar procedura për regjistrimin e markës.
- në **3** raste nuk është pranuar kërkesa e apelimit.
- në **1** rast nuk është pranuar kërkesa e apelimit si e pabazuar në ligj.
- në **1** rast jemi në proces shqyrtimi të apelimit.

Gjithashtu ka patur kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave ndërkombëtare nga sistemi i Madridit gjatë vitit 2016

Janë depozituar pranë Bordit të Apelimit të DPPM, **73** kërkesa të reja për kundërshtimin e një aplikimi ndërkombëtar për regjistrim marke, të publikuar në Buletinin e Markave të OBPI në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit

Bordi i Apelimit ka marrë vendim për **13** çështje duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **9** raste:
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës për **4** raste.

In the new legal amendments, the amendment and functioning of the Board of Appeal has also been seen as important. From a structure with three employees of the GDPT, it will become a structure with members come from the GDPT itself and members (experts) who are selected outside of the GDPT. Since all are specialists of the field, it will turn this Board into a more specialised and more independent organ for the taking of decisions, having an influence on the professionalism and impartiality of the rendering of decisions as well as significantly reducing the cases that are contested in court.

With these regulations to the Board of Appeal, the work of the administrative court will be significantly eased. Of course, the administrative court will have an important role, because it will verify and assess the validity of decisions of the Board of Appeal on the basis of the complaint against its decisions by interested persons.

During 2016, the Board of Appeal took decisions in 48 cases of oppositions to trademarks, deciding:

- acceptance of the complaint and refusal of the application for registration of a trademark in **28** cases:
- refusal of the complaint and continuation of the procedures of registration of the mark in 13 cases
- acceptance of the complaint for examination in three cases.
- dismissal of the examination because of withdrawal from the trademark or from the opposition complaint in four cases.

12 of the decisions of the Board were appealed to the Court of the Tirana Judicial District during 2016.

Seven trademarks refused by the Examination Directorate were appealed to the Board of Appeal during 2016.

- in **two** cases, the appeal request was accepted and the procedure continued for registration of the mark.
- in **three** cases, the appeal complaint was not accepted.
- in **one** case is in the process of examination of the appeal.

There were also complaints opposing the registration of international trademarks from the Madrid system during 2016

Seventy-three new complaints were deposited with the Board of Appeal of the GDPT opposing an international application for registration of a trademark, published by the WIPO Bulletin of Trademarks, on the basis of the Madrid Agreement and Protocol.

The Board of Appeal took a decision in **13** cases, deciding:

- acceptance of the complaint and refusal of the application for registration of the trademark in nine cases:
- rejection of the complaint and continuation of the procedures of registering the trademark in four cases.

- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në 2 raste.

Asnjë prej vendimeve të mësipërme të Bordit nuk është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

In 2016, the number of cases in court involving Industrial Property objects increased. The majority of the cases had the object of examination of “Verification of unfair competition”. This is a sign of the dynamics of the market of IP objects and the awareness of the holders of those rights about the important of protection and prohibiting the falsification of goods and services bearing those marks.

- the complaint for examination was not accepted in two cases.

None of the above decisions of the Board was appealed to the Tirana District Court.

Në vitin 2016 numri i çështjeve në Gjykatë mbi konfliktet e Objekteve të Pronësisë Industriale është rritur. Shumica e çështjeve kanë si objekt shqyrtimi “Vërtetimin e konkurrencës së pandershme”. Kjo është tregues i dinamikës së tregut të objekteve të Pronësisë Industriale dhe ndërgjegjësimit të mbajtësve të të drejtave të Pronësisë Industriale mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe ndalimit të fallsifikimit të mallrave dhe shërbimeve të tyre.

Tabela më poshtë jep numrin e çështjeve në Gjykatë mbi konfliktet e Objekteve të Pronësisë Industriale në vite.

The table below gives the number of court cases about conflicts over Industrial Property object by year.

Viti Year	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Nr. Çështjeve Number of cases	20	25	26	15	39	24	43



X. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Lehtësimi për marrjen dhe administrimin e informacionit shumë i rëndësishëm në kohët e sotme, kur teknologjia e informacionit ka pësuar një zhvillim të madh.

Për këtë një element kryesor në objektivat e DPPM për vitin 2016 ishte edhe përmirësimi i shërbimeve elektronike që ajo ofron.

Në Janar 2016 u konfigurua për procedimin e të gjithë vitit 2016, për arsye se sistemi funksionon me procedime vjetore, ku çdo ditë pune e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë. Janë administruar të drejtat e përdoruesëve në përputhje me profilin e punës, si dhe janë zgjidhur problemet e hasura nga këta të fundit gjatë përdorimit të sistemit.

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në DPPM ka patur një përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2016, me instalimin e infrastrukturës së re të serverave dhe data storage.

Është administruar dhe mirëmbajtur rrjeti kompjuterik (LAN) dhe është siguruar funksionimi i tij dhe i pajisjeve të instaluar në të. Sigurimi i back-up të përditshëm dhe testimi i funksionimit të tij, ka qënë një nga prioritetet kryesore të DPPM me qëllim sigurimin e ruajtjes së informacionit të plotë dhe të saktë për të bërë të mundur rikthimin e këtyre të dhënave në çdo rast dëmtimi.

Shërbimet elektronike u përmirësuan dhe regjistrat on-line përditësohen çdo javë nga çdo muaj që ishte më parë. Janë publikuar në portalin e-albania, informacionet për të gjitha shërbimet që ofron DPPM. Përfundoi dixhitalizimi i arkivës së patentave, markave në fazë kombëtare dhe disenjove industriale. Përfundoi klasifikimi i elementeve figurative të markave, që mundëson një shërbim më cilësor kërkimi. Përfundoi saktësimin e të dhënave të importuara automatikisht në sistem nga markat ndërkombëtare. Theksojmë se

X. INFORMATION AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

Facilitating the receipt and administration of information is very important today, when information technology has undergone great development.

For this purpose, a main element in the objectives of the GDPT was improving the electronic services that it provides.

In January 2016, it was configured for proceeding during the whole year, because the system functions with annual proceedings, where every working day of the year has the actions done on that day. The rights of users were administered in conformity with the work profile, and the problems encountered were solved by the latter during the use of the system.

The infrastructure of Information and Communication Technology in the GDPT was significantly improved during 2016, with the installation of new infrastructure of servers and data storage.

The computer network (LAN) was administered and maintained and its functioning and that of the equipment installed in it was assured. Securing daily back-up and testing its functioning has been one of the main priorities of the GDPT, for the purpose of preserving full and accurate information to enable the return of those data in any case of damage.

The electronic services were improved and the on-line registers were updated every week, compared to every month which it had been before. Information about all the services offered by the GDPT was published in the portal e-albania. The digitalisation of the archives of patents, trademarks in the national phase and industrial designates was completed. Also completed was the classification of figurative elements of trademarks, which enables a search service of better quality. Also completed was the making accurate of data imported automatically in the system from the international trademarks.

këto të dhëna nuk ishin të sakta që prej antarësimit të Shqipërisë në Sistemin e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave. Për vitin 2016 ka vijuar importimi në sistem nëpërmjet Modulit të Madridit i 9400 kërkesa për depozitim marke dhe dokumenta të tjerë, nga sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Si edhe është konfiguruar në sistem procedura për regjistrimin e këtyre markave.

Janë publikuar në total 12 buletinë për Patentat dhe Modelet e Përdorimit, dhe 12 buletinë për Markat Tregtare dhe Disenjove Industriale, duke ndikuar në shkurtimin e procedurave të ekzaminimit:

We emphasise that these data had not been made precise since the membership of Albania in the Madrid System for the International Registration of Trademarks. For 2016, importation into the system continued through the Madrid Module of 9,400 requests for the deposit of marks and other documents from the Madrid system for international registrations of trademarks. The procedure for registration of those marks in the system was also configured.

In total, 12 bulletins on patents and utility models were published, as well as 12 bulletins for trademarks and industrial designs, with an effect on shortening the examination procedures.



XI. FINANCA

Të ardhurat financiare janë tregues i rëndësishëm i performancës së një institucioni.

Falë reformave të ndërmarra nga DPPM si në përmirësimin e shërbimeve ashtu edhe promovimin e rolit të Pronësisë Industriale, është rritur me 40% numri total i aplikimeve që depozitohen për shqyrtim administrativ në DPPM, në këtë mënyrë është shtuar ndjeshëm edhe volumi punës që është dashur të përballojë DPPM, rrjedhimisht kjo ka sjellë edhe shtimin e shpenzimeve dhe të ardhurave e arkëtuara nga DPPM.

Faktorët që kanë ndikuar në shtimin e ngarkesës së punës janë: shërbimet e reja të ofruara nga DPPM, rritja e numrit të aplikimeve dhe aktivitetet e shumta që organizohen me qëllim ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e PI.

Po ti referohemi vetëm të dhënave nga zyra e protokollit rezultojnë që gjatë vitit 2016 janë protokolluar dhe dërguar aplikantëve, **12050** dokumenta të lëshuara nga DPPM. Janë pranuar në sistem **10200** kërkesa për depozitim të aplikimeve dhe dokumenta të tjerë. Për herë të parë në vitin 2016 të gjithë dokumentat e pranuar në protokoll janë skanuar dhe indeksuar në sistem.

Bazuar edhe në faktorët e lartpërmendur, por edhe në zbatim të parashikimeve të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intellektuale 2016-2020, si dhe në ndryshimet e fundit ligjore mbi Pronësinë Industriale, del në pah domosdoshmëria e rritjes së numrit të stafit të DPPM dhe krijimi i kushteve optimale për plotësimin e nevojave të drejtorisë me ambiente të mjaftueshme pune dhe kushtet logjistike të duhura.

Në DPPM burimet njerëzore konsiderohen si një faktor i rëndësishëm për rritjen e efikasitetit të saj

XI. FINANCE

Financial income is an important indicator of the performance of an institution.

Thanks to the reforms undertaken by the GDPM as well as the improvement of the services, as well as promotion of the role of Industrial Property, the total number of applications deposited for administrative examination in the GDPM has increased by about 40%, in this way significantly adding to the volume of the work that the GDPM has had to face. Consequently, this has also brought an increase of expenses incurred and income received by the GDPM.

The factors that have affected an increase in the work load are the new services offered by the GDPM, the increase in the number of applications and the many activities organised for the purpose of raising public awareness about the importance of IP.

If we refer only to data from the protocol office, it turns out that during 2016, **12,050** documents issued by the GDPM were protocolled and sent to applicants. Accepted into the system were **10,200** requests for the deposit of applications and other documents. For the first time in 2016, all the documents accepted in the protocol office were scanned and indexed in the system.

Based also on the above-mentioned factors, but also in implementation of the provisions of the National Strategy for Intellectual Property 2016-2020, as well as the latest legal amendments on Industrial Property, it became evident how essential it is to increase the number of staff of the GDPM and to create optimal conditions for meeting the needs of the directorate with sufficient working environments and appropriate logistic conditions.

Human resources are considered an important

dhe për këtë arsye rekrutimi, trajnimi, vlerësimi, qëndrueshmëria e punonjësve të DPPM është qëllimi ynë.

Aktualisht DPPM është një institucion publik buxhetor me mjete financiare, logjistike dhe administrative shumë të kufizuara. Kjo formë organizimi e bën DPPM jofleksibël në realizimin e misionit të saj, si dhe në përmbushjen e kërkesave të tregut për arritjen e standarteve ndërkombëtare në shërbimet që ofron. DPPM gjeneron të ardhura nga regjistrimi i objekteve të PI. Këto të ardhura derdhen 100% në buxhetin e shtetit, nga të cilat një pjesë shumë e vogël përdoret për mbajtjen e sistemit të PI-së në vend. Vlera tjetër e siguruar nga DPPM përdoret në fusha të tjera, duke lënë të paplotësuara nevojat në këtë fushë. Ky problem është kapur dhe trajtuar edhe në raportet dhe vlerësimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Të ardhurat që DPPM realizon përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, të gjitha këto të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPM.

Gjithashtu, është parashikuar që këto të ardhura të përdoren edhe për aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, pasi sic duket edhe në raportet vjetore të mëparshme të DPPM pjesa më e madhe e aplikimeve vijnë nga aplikues të huaj dhe del e nevojshme pjesëmarrja e DPPM në aktivitete promovuese dhe panairë të zhvilluara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për të promovuar regjistrimin e pronës industriale në Shqipëri.

Në vitin 2016 DPPM ka investuar nga buxheti i saj në forcimin e kapaciteteve njerëzore duke mundësuar rritjen e stafit me 9 persona të tjerë, në përmirësimin e kushteve të punës me mjetet e nevojshme logjistike, si dhe mundësimin e pjesëmarrjes në mbledhjet, takimet dhe trajnimin e stafit në seminarët e organizuara nga organizatat ndërkombëtare të PI në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

Të ardhurat që DPPM gjeneron realizojnë një buxhet disa herë më të lartë se buxheti që DPPM merr aktualisht. Me tendencën gjithmonë në rritje të volumit të punës, është mëse e sigurt që këto të ardhura do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen, prandaj del domosdoshmëri që të financohet edhe me mjete të tjera të ligjshme të ndryshme nga ato të buxhetit të përgjithshëm të shtetit.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.

Konkretisht të ardhurat që DPPM gjeneron vijnë nga:

- Të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, e Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për disenjo industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet

factor in the GDPM for increasing its efficiency, and for this reason, the recruitment, training, evaluation and stability of the employees of the GDPM is our goal.

Currently, the GDPM is a public budgetary institution, with very limited financial, logistic and administrative means. This form of organisation makes the GDPM inflexible in accomplishing its mission, as well as in fulfilling the requirements of the market to reach international standards in the services that it offers.

The GDPM generates income from the registration of IP objects. That income is deposited 100% into the state budget, of which a very small part is used for maintenance of the IP system in the country. The other values obtained by the GDPM are used in other fields, leaving the needs unfulfilled in this field. This is an open problem and it has also been dealt with in the reports and assessments of the European Commission on Albania.

The income of the GDPM is used for pay, insurance and expenses, operating expenses and capital investments, various activity of the field of industrial property, with the country and outside it, all of this being necessary for the exercise and accomplishment of the functions of the GDPM.

In addition, it has been foreseen that that income will also be used for various activities in the field of industrial property, within the country and outside it, because as can also be seen in the prior annual reports of the GDPM, the largest part of applications come from foreign applicants, in the participation of the GDPM in promotional activities and trade fairs held outside the territory of the Republic of Albania is necessary, in order to promote the registration of industrial property in Albania.

In 2016, the GDPM invested from its budget in strengthening human capacities, enabling the growth of its staff by nine more persons, in improving working conditions with necessary logistical means and also in making possible participation in gatherings, meetings and the training of the staff in seminars organised by international IP organisations in which the Republic of Albania is a member.

The income that the GDPM generates is for a budget several times higher than that which the GDPM currently receives. With the steady tendency for an increase in the volume of work, it is more than certain that this income will continue to grow in the future, and there it is essential that it be financed also by other lawful means rather than those of the general budget of the state.

Table of budgetary expenses and income

Concretely, the income generated by the GDPM comes from:

- Income from Madrid System tariffs for the registration of international marks, of the Hague Agreement for international applications for industrial designs, as well as all other agreements that the Republic of Albania has entered

e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e Pronësisë Industriale.

- Të ardhurat e tjera që realizohen nga aktivitetet në fushën e Pronësisë Industriale.
- Të ardhura të tjera që mund të realizohen sipas legjislacionit në fuqi.

into or will enter into in the field of Industrial Property.

- Other income realised from activities in the field of Industrial Property.
- Other income that might be realised according to the legislation in force.

STATISTIKA


STATISTICS

Vit buxhetor	Të ardhura nga OBPI Income from WIPO (Swiss francs) Exchange rate Kursi 125.53	Të ardhura ZEP Income from the EPO (euro) Exchange rate Kursi 137.60	Të ardhura Aktivitet kryesor Income Principal activity (lek)	Shpenzime Fakt (lek) Buxheti Expenses in fact (Budget)	Shpenzime Fakt (lek) Nga 10% i të ardhurave Actual expenses (lek) From the 10 % of the incomes
Viti 2013	473,361.05CHF 59,421,012.6065ALL	22,623.55€ 3,113,000.48ALL	63,644,291.00ALL	19,423,715ALL	0
Viti 2014	493,515.15CHF 61,950,956.7795ALL	19,555.95€ 2,690,898.72ALL	73,924,623.50ALL	19,539,268ALL	0
Viti 2015	529,538.03CHF 66,472,908.9059ALL	8,052.45€ 1,108,017.12ALL	81,108,236.49ALL	19,582,314ALL	4,950,152ALL
Viti 2016	557,722.92 CHF 70010958.14 ALL	6190 € 851751.52 ALL	87845808.29 ALL	28,357,443 ALL	6,226,751

Për funksionimin dhe përmbushjen e misionit të saj, DPPM do të mbështetet tërësisht në të ardhurat që ajo krijon nga aktiviteti i saj. Të ardhurat që DPPM gjeneron realizojnë një buxhet disa herë më të lartë se buxheti që DPPM merr aktualisht. Me tendencën gjithmonë në rritje të volumit të punës, është mëse e sigurt që këto të ardhura do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen.

For the functioning of the GDPM and for meeting its mission, the GDPM will rely entirely on the income that it creates from its activity. The income that the GDPM generates is for a budget several times higher than that which the GDPM currently receives. With the steady tendency for an increase in the volume of work, it is more than certain that this income will continue to grow in the future, and there it is essential that it be financed also by other lawful means rather than those of the general budget of the state.

VITI YEAR	Të ardhura ALL Income (ALL)	Shpenzime ALL Expenses (ALL)	Diferenca/ Teprica Difference/Excess
2013	126,178,304.0865	19,423,715	106,754,589.0865
2014	138,566,478.9995	19,539,268	119,027,210.9995
2015	148,689,162.5159	24,532,466	124,156,696.5159
2016	158,708,517.95	34,584,194	124,124,323.95



Shpenzimet e DPPM-së me 24 punonjës shkojnë **21,542,532ALL** ndërsa shpenzimet e personelit për më shumë se 30 punonjës siç është parashikuar në PBA dhe në Strategjinë Kombëtare për Pronësinë

The expenses of the GDPM with 24 employees amount to **21,542,532 ALL** while personnel expenses for more than 30 employees, as has been projected in the PBA and the National

Intelektuale 2016-2020 për vitin 2017 janë **26,653,200 ALL**, shpenzimet e Këshillit Mbikqyrës dhe Bordit të Apelit janë në total nga **735,000** në **1,470,000 ALL**.

Pra shtesa e shpenzimeve në total varion nga **5,845,668 ALL** deri në **11,613,948 ALL**.

Krahasuar me të ardhurat e vitit 2015 të cilat ishin **148,689,162.5159 ALL** duket që shtesa e shpenzimeve të personelit është e papërfillshme. Pjesa e të ardhurave të cilat do të mbeten DPPM-së do të investohen për përsëri në fushën e Pronësisë Industriale. DPPM do t'i përdori fondet për plotësimin e objektivave dhe detyrimeve të cilat i rrjedhin nga funksioni i saj kryesor pasur për një cilësi të lartë egzaminimi, promovimi të objekteve të PI, shërbimi, si dhe realizimin e objektivave të marra. Një pjesë e konsiderueshme e fondeve do të shkojë për realizimin e projekteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare 2016-2020.

Hartimi i projekt ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", në vitin 2016, ishte një nismë e rëndësishme e DPPM për sa i përket financave të saj.

Ky projekt ligj e kthen DPPM nga një institucion publik buxhetor në një agjensi autonome. Ndryshimi i formës së organizimit sipas propozimit në projektligj do të ndikojë në:

- fleksibilitet në marrjen e vendimeve për përmbushjen e detyrave.
- mjete logjistike dhe administrative në përputhje me kërkesat e kohës.
- investimin e të ardhurave që krijohen nga PI në po këtë fushë.

Parashikimi i saktë në PBA i buxhetit për qëllime të forcimit të sistemit të Pronësisë Industriale nga DPPM është shumë i vështirë pasi projektet në fushën e PI janë projekte të vazhdueshme të cilat zgjasin mbi një vit kalendarik dhe si të tilla nuk mund të parashikohen dhe të kufizohen në tavane buxhetore.

Kjo formë organizimi është praktikë e të gjitha vendeve të zhvilluara. Ndryshimi i strukturës administrative të DPPM nga një institucion publik buxhetor në një institucion me vet financim me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj, është një rekomandim i lënë nga komisioni Evropian, si dhe është parashikuar në Strategjinë kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020 të miratuar me VKM nr. 527 dt.20/07/2016 dhe publikuar në fletoren Zyrtare nr.140 dt.28/07/2016.

Në periudhën në vazhdim investimet do të fokusohen në disa drejtime kryesore si:

- Rritja e cilësisë së ekzaminimit, si fushë e vecantë që kërkon specializim të thellë të specialistëve të DPPM. Njohuritë e fushës së PI formohen duke u specializuar vazhdimisht nga institucionet ndërkombëtare të fushës së Pronësisë Industriale, për arsyen se asnjë universitet brenda ose jashtë vendit nuk diplomon ekspertë të kësaj fushe. Ekspertët e fushës së Pronësisë Industriale janë aktoret themelore në

Strategy for Intellectual Property 2016-2020 are, for 2017, **26,653,200 ALL**, with the expenses of the Supervisory Council and the Board of Appeal being, in total, from **735,000** to **1,470,000 ALL**.

That is, in total, the addition to expenses varies from **5,845,668 ALL** to **11,613,948 ALL**.

Compared with the income of the year 2015, which was **148,689,162.5159 ALL** it can be seen that the increase of expenses for personnel is insignificant. The part of the income that will remain with the GDPM will be invested in the field of Industrial Property. The GDPM will use the funds to meet the objectives and obligations that come from its main activity, to have a high quality of organisation, promotion of IP objects, service and also realisation of the objectives undertaken. A considerable part of the funds will go for the realisation of projects foreseen in the National IP Strategy 2016-2020.

The drafting of the law in 2016 "On some additions and amendments to law no. 9947 dated 07.07.2008 "On industrial Property" was an important initiative of the GDPM concerning its finances. This draft law turns the GDPM from a public budgetary institution into an autonomous agency.

Changing the form of organisation according to the draft law will have an effect on:

- flexibility in taking decision to meet its duties;
- logistical and administrative means in conformity with the requirements of the time;
- the investment of income created by IP in the same field.

An exact projection in the medium term budget (PBA) for purposes of strengthening the system of Industrial Property by the GDPM is very difficult, because projects in the Industrial property field are continuing contracts that extend over more than one calendar year and as such cannot be foreseen and limited to budgetary ceilings.

This form of organisation is the practice of all developed countries. The change of the administrative structure of the GDPM from a public budgetary institution with self-financing for purposes of strengthening administrative and financial capacities, as a principal element of realising its mission, is a recommendation made by the European Commission and has also been provided in the National Strategy for Intellectual Property 2016-2020 approved by CMD no. 527 dt. 20/07/2016 and published in Official Journal no. 140 dt. 28/07/2016.

In the period to follow, investments will be focused in several main directions, such as:

- Increasing the quality of examination, as a special field that requires deep specialisation of GDPM specialists. Knowledge in the field of IP is formed by specialising continually from the international institutions of the field of Industrial Property, because no university within the country or outside it has experts in this field. The experts of the Industrial Property field are

sistemin e PI dhe si të tillë, specializimi dhe motivimi i tyre mbetet një nga detyrat e zyrës në realizimin me cilësi të funksioneve të saj.

- Sigurimi i një selie të përhershme në Tiranë dhe i ambienteve të përshtatshme të punës, del si domosdoshmëri për arsye se puna e DPPM është kryesisht e lidhur me bizneset dhe publikun në përgjithësi dhe si e tillë është shumë e rëndësishme që ajo të ketë një vend të pandryshueshëm për të ushtruar aktivitetin e saj. Për analogji theksojmë se zyrat homologe në botë janë të vendosura në qendrat kryesore të kryeqyteteve.
- Përmbushja e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare si OBPI dhe në ZEP, si dhe së shpejti me anëtarësimin e vendit tonë në BE do të bëhemi edhe anëtarë të ZBEPI. Këto organizata japin investime në përputhje me rregullat e tyre dhe shtetet anëtare janë të detyruara t'i zbatojnë, si detyrim që u lind nga ratifikimi i marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare. Një pjesë e mirë e këtyre investimeve janë investime të pjesshme dhe pjesa tjetër duhet të mbulohet nga institucioni i vendeve anëtare. Shumë aktivitetet si këto deri më sot nuk janë zbatuar për shkak se ndryshojnë procedurat që parashikojnë këto organizata dhe procedurat që zbatohen në Republikën e Shqipërisë për prokurimin publik.
- Zhvillimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin e publikut për regjistrimin dhe respektimin e të drejtave të objekteve të PI si dhe trajnimin e palëve të përfshira në sistem. Këto trajnime duhet të jenë sa më të shpeshta dhe cilësore. Sfidat e DPPM për të ardhmen është krijimi i një Qendre të Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale brenda strukturës së saj, e cila do të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë. Kjo është një praktikë e të gjitha vendeve të zhvilluara. Por, për arritjen e kësaj sfide, nuk nevojiten vetëm ekspertët e fushës, të cilët DPPM duhet t'i specializojë vazhdimisht, por nevojiten edhe investime të konsiderueshme në infrastrukturë.
- Ofrimi i shërbimeve të reja mbi teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit duke krijuar e mundësinë e aplikimit on-line në funksion të lehtësimit të procedurave të regjistrimit të objekteve të PI, si dhe të rregullohet pranimi i nënshkrimit elektronik dhe pagesave on-line, për rritjen e shpëjtësisë së shërbimeve të DPPM si dhe për uljen e kostove të aplikantit. Me këto shërbime DPPM të jetë në të njëjtin nivel me zyrat homologe të vendeve të zhvilluara të cilat janë dinamike në këtë drejtim, si dhe do të plotësohen detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo patjetër kërkon investime në infrastrukturë dhe trajnime të specialistëve në DPPM dhe institucioneve të tjera të përfshira.

the fundamental actors in the IP system, and as such, giving them specialisation and motivating them remains one of the duties of the office in realising its functions with high quality.

- Securing permanent headquarters in Tirana and appropriate working premises is essential, because the work of the GDPM is primarily linked with businesses and the public in general, and as such, it is very important that it have a place that does not change in order to exercise its activity. We stress that, for analogy, the homologous offices around the world have been placed in the main centres of the capital cities.
- The fulfilment of the obligations that derive from the membership of the Republic of Albania in international organisations such as WIPO, the EPO and also, soon, with our country's EU membership, we will become a member of the EUIPO. Those organisations make investments in accordance with their rules, the Member States are obliged to implement them as an obligation that arises from the ratification of the international agreements and conventions. A good part of these investments are partial investment, and the other part has to be covered by the Member State institution. Many activities such as those have until today not been implemented because the procedures of those organisations differ from the procedures applicable in the Republic of Albania for public procurement.
- The conduct of activities for raising public awareness about registering and respecting the rights of IP objects, as well as training the parties involved in the system. Those trainings should be as frequent as possible and of quality. The challenge to the GDPM for the future is to create a Training Centre in the Industrial Property Field, within its structure, which will perform continuing training of all actors in the system, as well as preparing informative texts in this field. This is a practice of all developed countries. However, in order to meet this challenge, not only are experts of the field, specialised constantly by the GDPM, are needed, but considerable investments in infrastructure are also needed.
- Providing new services of Information Technology and Communications Technology, creating the possibility for on-line application in the service of facilitating the registration procedures for IP objects, as well as regulating the acceptability of electronic signature and on-line payment, for speeding up the services of the GDPM as well as lowering the costs of application. With these services, the GDPM will be at the same level as the homologue offices of developed countries, which are dynamic in that aspect, and will also fulfil the obligations deriving from international agreements. This will doubtless require investments in infrastructure and training of the GDPM's specialists and those of other involved institutions.

XII. AKTIVITETET

Konferenca e datës 26 Prill, Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale.

“Reforma në Sistemin e Pronësisë Intelektuale - Sfidë dhe Angazhim për Integrimin Evropian dhe Zhvillimin Ekonomik të Vendit”, ishte slogan i kësaj konference.



Organizimi i kësaj konference kryhet çdo vit me rastin e Ditës Botërore të PI, datë 26 Prill, me qëllim promovimin dhe ndërgjësimin e publikut, krijuesëve dhe biznesit për rëndësinë e PI.

Ky aktivitet organizohet nga DPPM dhe është bërë tashmë traditë në Shqipëri. Këtë vit nderuan me pjesëmarrjen e tyre në konferencë dhe mbajtën fjalime në panel, Ministria e MZHTTS, znj. Milva Ekonomi, Ministria e Ministrisë së Kulturës, znj. Mirela Kumbaro Furxhi, përfaqësuesi i Komisionit Evropian, z. Yngve Engstroem, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane, z. Don Brown, Oficer për çështjet ekonomike. Gjithashtu në panelin e dytë në këtë konferencë, mbajtën fjalim, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM z. Elvin Lako, përfaqësuesi i ZEP z. David Jelercic, Drejtori i ZSHDA z. Evien Dako, Këshilltari ligjor në Ministrinë e Kulturës z. Edmond Ahmeti, si dhe z. Piro Milkani, Regjisor.

Në këtë konferencë u theksua fakti se PI përbën një nga prioritetet e qeverisë shqiptare. Në kushtet aktuale lind nevoja për hapa të mëtejshëm në këtë fushë, dhe synohet për një reformë të sistemit drejt standarteve të Bashkimit Evropian, duke hapur kështu një kapitull të ri të PI në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor ashtu edhe duke krijuar një mjedis të besueshëm dhe efikas për mbrojtjen e saj. Qëllimi i Qeverisë Shqiptare në fushën e PI është të stimulojë

XII. ACTIVITIES

Conference of 26 April, World Intellectual Property Day

“Reform in the System of Intellectual Property- A Challenge and Commitment for European Integration and the Economic Development of the Country” was the slogan of this conference.

The conference is organised each year on the occasion of World IP Day, 26 April, for the purpose of promoting and raising awareness of the public, creators and business about the importance of IP.

This activity is organised by the GDPT and has now become a tradition in Albania. This year, we were honoured with the participation at the conference, and their speeches in a panel, by Ms. Milva Ekonomi, the Minister of MEDTTE; Ms. Mirela Kumbaro Furxhi, the Minister of Culture; a representative of the European Commission, Mr. Yngve Engstroem, a representative of the American Embassy, the officer for economic issues, Mr. Don Brown. In addition, a second panel at that conference included speeches by Mr. Elvin Lako, the Director General of the GDPT, a representative of the EPO, Mr. David Jelercic, and Mr. Evien Dako, Director of the Albanian Copyright Office, as well as director Pirro Milkani.

It was stressed at this conference that IP constitutes one of the priorities of the Albanian government. Under current conditions, the need arises for further steps in this field, and it is aimed to have a reform of the system toward the standards of the European Union, in this way opening a new chapter for IP in Albania through the improvement of IP in Albania, as well as by creating an efficient and trustworthy environment for its protection. The purpose of the Albanian Government in the IP

zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të përshtatshëm të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të PI dhe interesave të përdoruesve si dhe të forcojë sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes së Pronësisë Intelktuale.

Pjesëmarrësve në këtë konferencë iu prezantua edhe draft Strategjia Kombëtare mbi PI 2016-2020. Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, z.Elvin Lako në fjalimin e tij paraqiti një tablo të kësaj strategjie të re, me qëllim konsultimin publik të përmbajtjes së saj. Kjo strategji u cilësua si një dokument politik i cili do të orientojë institucionet shqiptare dhe ato të huaja të përfshira në sistemin e PI drejt harmonizimit të punës ndërmjet tyre, përmirësimit të kuadrit ligjor mbi PI dhe promovimit të gjerë të sistemit të PI. Të gjitha këto parashikime të strategjisë i shërbejnë qëllimit kryesor të saj për forcimin e sistemit të PI në Shqipëri, duke stimuluar zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, sigurimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të PI dhe interesave të përdoruesve.

Kjo konferencë u pasqyrua edhe në mediat audio-vizive vendase duke sjellë së bashku, shpikës, artistë, biznese, përfaqësues të të drejtave të PI dhe duke promovuar rëndësinë e saj, ndërgjegjësimin e politikëbërësve dhe biznesit për krijimin e tregut të bazuar në konkurrencën e ndershme dhe respektimin e të drejtave të PI.

Konferenca solli mesazhin për të gjithë publikun e gjerë se, është shumë e rëndësishme t'i japim vetes dhe vendit tonë mundësitë dhe benefitet më të mira që PI na ofron, duke i sjellë zhvillimin e mëtejshëm ekonomisë sonë dhe hapa konkretë drejt integritimit në Bashkimin Evropian.

- Takimi vjetor “Mbi Bashkëpunimin e Vendeve Anëtare të Organizatës Evropiane të Patentave”

Në datat 16-17 qershor 2016 në Shqipëri për herë të parë u zhvillua Takimi i 10-të vjetor “Mbi Bashkëpunimin e Vendeve Anëtare të Organizatës Evropiane të Patentave”

field is to stimulate economic, scientific and cultural development in the country, to assure an appropriate functioning of the internal market by establishing an appropriate balance between the rights of the owners of IP objects and the interests of the users, as well as to strengthen the system of registration and protection of Intellectual Property.

The draft National Strategy for IP, 2016-2020, was also presented to the participants in this conference. The Director General of the GDPT, Mr. Elvin Lake, presented a picture of this new strategy in his remarks, for the purpose of public consultation on its contents. The strategy was characterised as a political document that will orient the Albanian institutions and foreign ones involved in the IP system towards harmonising work between them, improving the legal framework on IP and broadly promoting the IP system. All those provisions of the strategy are in the service of its main purpose to strengthen the IP system in Albania, stimulating economic and cultural development in the country also assuring the functioning of the internal market by establishing the appropriate balance between the rights of the owners of IP objects and the interests of users.

This conference was also reflected on the local audio-visual media, bringing together inventors, artists, businesses and representatives of IP rights and promoting the importance of IP, raising the awareness of policymakers and business for the creation of a market based on honest competition and respect for IP rights.

The conference brought a message for the entire public at large that it is important to give ourselves and our country the best opportunity and benefits that IP provide, bringing the further development of our economy and concrete steps toward integration with the European Union..

- Annual meeting “On the cooperation of the Member States of the European Patent Organisation”

On 16-17 June 2016, for the first time in Albania, the 10th Annual Meeting “On the cooperation of the Member States of the European Patent Organisation” was held.



Organizata Evropiane e Patentave është një organizatë ndërkombëtare e krijuar më 7 tetor 1977 në bazë të Konventës Evropiane të Patentave (KEP) të nënshkruar në Mynih në vitin 1973. Ajo është e përbërë nga dy trupa, Zyra Evropiane e Patentave dhe Këshilli Administrativ, i cili mbikëqyr aktivitetin e zyrës. Aktualisht kjo organizatë ka 38 vende anëtare ku drejtuesit e zyrave të PI të secilit vend janë kryetarë të delegacionit dhe përfaqësues të vendit anëtar në Këshillin Administrativ. Shqipëria është anëtare me të drejta të plota që prej datës 1 Maj 2010. Takimi vjetor “Mbi Bashkëpunimin e Vendeve Anëtare të Organizatës Evropiane të Patentave këtë vit përkonte me 10-vjetorin e saj. ZEP zgjodhi që këtë vit takimin ta zhvillojë në Tiranë, në datat 16-17 Qershor 2016. Në konferencë ishin të pranishëm edhe Ministrija e MZHEKUT, znj. Milva Ekonomi, Presidenti i ZEP z. Benoît Battistelli dhe stafi drejtues i ZEP si dhe përfaqësues të lartë të 38 zyrave të Pronësive Intelektuale nga shtetet anëtare ose jo. ZEP dhe delegacionet e shteteve anëtare të saj, takohen çdo vit në muajin Qershor për të diskutuar mënyrat e bashkëpunimit të mëtejshëm midis tyre me synim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetin e sistemit të mbrojtjes së patentave evropiane duke i shërbyer më mirë shpikësit dhe industrisë. Ky takim përbën një rëndësi të veçantë dhe i shërben konsolidimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me ZEP e cila është një nga institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare për nxitjen e inovacionit. Bashkëpunimi me ZEP i vjen në ndihmë Shqipërisë për orientimin drejt arritjes të standarteve bashkëkohore për mbrojtjen e PI.

Organizimi i këtij takimi përveç anës formale të tij u konceptua të zhvillohet edhe në aspektin kulturor me qëllim promovimin e traditave dhe turizmit të vendit tonë. Pjesëmarrësit u shoqëruan me guida dhe vizituan pika turistike të vendit tonë, në mënyrë që ata të njihen me historinë dhe vlerat e vendit tonë. Për këtë qëllim u organizuan vizita në qytetin e Krujës, në Pallatin e Brigadave, në ish vilën e diktatorit Enver Hoxha, si dhe u organizua darkë festive në Malin e Dajtit.”

Megjithatë në këtë event mori pjesë Presidenti i ZEP, z. Benoît Battistelli, u krijua mundësia takimeve zyrtare me përfaqësues të lartë të Qeverisë Shqiptare, si znj. Milva Ekonomi, Ministre e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe me znj. Milena Harito, Ministre për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Gjithashtu u mundësua edhe promovimi mediatik i këtij eventi nëpërmjet deklaratave apo konferencave të përbashkëta për shtyp, ku u pasqyrua roli dhe rëndësia e kësaj organizate si dhe bashkëpunimi i Shqipërisë me të.

The European Patent Organisation is an international organisation created on 7 October 1977 on the basis of the European Patent Convention (EPC) signed in Munich in 1973. It is made up of two bodies, the European Patent Office and the Administrative Council, which supervises the activity of the office. Currently, this organisation has 38 member countries, with the directors of the IP offices of each country are the chairmen of the delegation and the representative of the member state in the Administrative Council.

Albania has been a member with full rights since 1 May 2010. The annual meeting “On the cooperation of the Member States of the European Patent Organisation” coincided this year with its tenth anniversary. The EPO chose to hold the meeting in Tirana this year on 16-17 June 2016.

Present in the conference were Ms. Milva Ekonomi, Minister of MEDTTE; Mr. Benoît Battistelli, President of the EPO, and the management staff of the EPO, as well as high representatives of the 38 intellectual property offices from member states or not. The EPO and the delegations from its member states meet every year in June to discuss ways of further cooperation among themselves with the aim of improving the quality and effectiveness of the system of protecting European patents, better serving inventors and industry.

This meeting has special importance and serves the consolidation of the relations of Albania with the EPO, which is one of the most important international institutions encouraging innovation. Cooperation with the EPO assists Albania in its orientation toward reaching contemporary standards for protecting IP. In addition to its formal side, the organisation of this meeting has also been conceived to be held in the cultural aspect, for the purpose of promoting the traditions of our country and tourism in it. The participants were accompanied by guides and visited tourist spots of our country, so that they would learn about the history and values of our country. Visits to the city of Kruja, the Palace of the Brigade, the former villa of dictator Enver Hoxha were organised for this purpose, as well as festive dinners on Dajti Mountain.

Since the President of the EPO, Mr. Benoît Battistelli, took part in this event, there was an opportunity for official meetings with high representatives of the Albanian Government, such as the Minister of Economic Development, Trade, Tourism and Entrepreneurship, Ms. Mila Ekonomi, as well as the Minister for Innovation and the Public Administration, Ms. Milena Harito.

Media promotion of this event was also made possible through declarations or joint press conferences reflecting the role and importance of this organisation as well as Albania's cooperation with it.



I ftuar nderi në Takimin vjetor “Mbi Bashkëpunimin e Vendeve Anëtare të Organizatës Evropiane të Patentave” ishte Profesor Shuajp Kraja, shpikësi i parë shqiptar me patentë evropiane për vaksinën kundër kancerit.

The guest of honour at the annual meeting “On the cooperation of the Member Countries of the European Patent Organisation” was Professor Shuajp Kraja, the first Albanian inventor with a European patent for a vaccine against cancer.



Prof. Shuajp Kraja ka lindur në qytetin e Shkodrës në vitin 1936. I specializuar për biologji molekulare, Prof. Kraja ka një karrierë të pasur shkencore e akademike, që i kalon kufijtë shqiptarë.

Gjatë këtij eventi Profesor Kraja dhe shpikja e tij u prezantuan pjesëmarrësve në takim. Ai në këtë event u nderua nga ZEP me një titull falenderimi për punën e tij krijuese. Vaksina kundër kancerit është konsideruar si një shpikje inovative në fushën e mjekësisë, lëshimi i kësaj patente nga ZEP, i hap rrugën procedurave për marrjen e autorizimit të prodhimit të saj nga Bashkimi Europian. Në kuadër të studimit pilot me pacientë vullnetarë, me Bi vaksinën antikancer janë trajtuar e shëruar për një kohë të gjatë disa dhjetëra raste ndër vite.

Ajo shfaq siguri të plotë në trajtimin dhe shërimin e formave të ndryshme të kancerëve, pa rishfaqje të tyre. Bi vaksina përbën një mënyrë mjekimi shumë më të përshtatshme që konkuron dhe do të zëvendësojë “artilerinë” e rëndë të kimioterapisë dhe radioterapisë si një gjilpërë inteligjente (timolimfocite hiperimune me informacion selektiv të ri), që do të jetë në gjendje ndërmjet trilionave qelizash të organizmit (normale dhe malinje), të dallojë dhe të vrasë në mënyrë selektive

Prof. Shuajp Kraja was born in the city of Shkodër in 1936. Specialised in molecular biology, Prof. Kraja has had a rich scientific and academic career, going beyond the borders of Albania.

During this event, Professor Kraja and his invention were presented to the participants in a meeting. He was honoured in this event by the EPO with a title of appreciation for his creative work. The vaccine against cancer has been considered an innovative invention in the field of medicine, and the issuance of this patent by the EPO opens the way to the procedures for receiving authorisation for its production by the European Union.

In the framework of the pilot study with volunteer patients, several dozen cases have been treated with the Bi anti-cancer vaccine and cured for long periods of time. This shows full security and the cure of several forms of cancers, without their reappearance. The Bi vaccine constitutes a manner of cure much more appropriate, which competes with and will replace the “heavy artillery” of chemotherapy and radiation treatment as an intelligent needle (hyperimmune thymic lymphocytes with new selective information), which will be in a condition a condition to distinguish among trillions of cells of the organism (normal and

qelizat malinje pa dëmtuar qelizat e shëndosha të organizmit.

Bi vaksina aplikohet për mjekimin e formave të ndryshme të kancerit dhe po ashtu vlen në imunizimin kundër shfaqjes së kancerit në persona të shëndoshë, por të predispozuar për të zhvilluar kancer. Profesor Kraja ka marrë po ashtu një patentë të dytë në nivel evropian për medikamentin “Shukrain 55” edhe kjo e regjistruar për patentim pranë institucionit të Regjistrimit të Patentave dhe Markave, këtë radhë në Gjermani. Medikamenti ka një spektër të gjerë dhe është vërtetuar gjithashtu efektiv ndaj viruseve patogjene të rrezikshme për shëndetin e njeriut si hepatitet virale HIV AIDS dhe gripit, duke parandaluar epideminë e tij. Në pranverën e vitit 2015 është konfirmuar pranimi i këtij medikamenti si inovacion i patentuar medicinal duke ju dhënë e drejta e prodhimit industrial.

DPPM merr pjesë në Konferencën ndërkombëtare “10 vjet tregti e lire - sfidat dhe perspektiva”

malignant) and selectively kill those cells that are malignant without harming the organism's healthy cells.

The Bi vaccine is applied to the treatment of various forms of cancer and is also able to immunise against the appearance of cancer in healthy persons, but who are predisposed to develop cancer. Professor Kraja has also taken out a second patent at the European level for the medicine “Shukrain 55”, this also registered for a patent at the institution of the Registration of Patents and Marks, this time in Germany. The medicine had a broad range of uses and has also been proven effective against pathological viruses that are dangerous to human health such as viral hepatitis, HIV/AIDS and flu, preventing epidemics. In spring year 2015, the acceptance of this medicine was confirmed as a patented medicinal innovation, granting the right to industrial production.

The GDPT takes part in the international conference “Ten years of the free market – challenges and perspectives”



Në “Konferencën ndërkombëtare “ 10 vjet tregti e lirë-sfidat dhe perspektiva” - paneli i tretë “ Dialogu publik-privat, faktor për rritje të qëndrueshme ekonomike” të organizuar nga MZHETTS, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM-së, z. Elvin Lako prezantoi rolin e Pronësisë Industriale për nxitjen e tregtisë dhe thithjen e investimeve të huaja direkte. Në këtë konferencë u shpalosën gjithashtu politikat dhe vizioni i Qeverisë shqiptare për zhvillimin dhe reformimin e sistemit të Pronësisë Industriale në Shqipëri si një mjet që ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe garantimin e mbrojtjes të të drejtave të pronësisë. Me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht MZHETTS, është e angazhuar maksimalisht në reforma të cilat synojnë krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të

In the international conference “Ten years of the free market – challenges and perspectives,” the third panel, “Public-private dialogue: a factor for stable economic growth,” organised by MEDTTE, the Director General of the GDPT, Mr. Elvin Lako, made a presentation about the role of Industrial Property in encouraging trade and made a call for direct foreign investments. Also unveiled in this conference were the policies and vision of the Albanian Government for developing and reforming the system of Industrial Property in Albania as a means affecting the country's economic development, as well as guaranteeing the protection of ownership rights. For the purpose of attracting foreign investments, the Albanian Government, and in particular MEDTTE, has been engaged to the maximum extent in reforms that aim at creating an appropriate environment for honest competition and

konkurrencës së ndershme dhe tregtisë së lirë si dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit si: sistemi ligjor i konsoliduar për regjistrimin dhe zbatimin e të drejtës së Pronësisë Industriale; antarësimi në marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare të PI, për vetë faktin se ato garantojnë standarte dhe praktika të njëjta në territore të ndryshme; promovimi i PI dhe ndërgjegjësimi i publikut; procedura administrative të lehta dhe eficiente. Të gjitha këto masa janë të përfshira në Strategjinë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020. Pjesëmarrja në këtë konferencë tregon edhe një herë vëmendjen dhe rëndësinë e shtuar që i jepet mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në Shqipëri.

Mbledhje e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të PI, 2016-2020.

free trade as well as sustainable economic development of the country, such as” a consolidated legal system for the registration and application of Industrial Property law, membership in international IP conventions and agreements, for the very fact that they guarantee standards and practices that are the same in different countries, the promotion of IP and raising the public’s awareness, and simple and efficient administrative procedures. All those measures have been included in the National Strategy for Intellectual Property 2016-2020. Participation in this conference shows once again the attention and added importance given to the protection of Intellectual Property in Albania.

Meeting of the work group for drafting the National IP Strategy 2016-2020.



Në datën 29 Janar 2016, u zhvillua takimi i Grupit Ndërinstitucional të punës për hartimin të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020. Takimi u zhvillua në ambientet e MZHETTS dhe u drejtua nga z. Ervin Mete, Zv.ministër. DPPM është sekretariat teknik i këtij grupi.

Seminar, “Rëndësia e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nga Biznesi Shqiptar”Tiranë.

On 29 January 2016, a meeting was held of the inter-institutional working group to draft the National Strategy of Intellectual Property 2016-2020. The meeting took place in the premises of the MEDTTE and was chaired by Mr. Ervin Mete, deputy minister. The GDPT is the technical secretariat of this group.

Seminar, “Importance of protecting intellectual property by Albanian business”Tirana



Më datë 02.06.2016, me mbështetjen e projektit Enterprise Europe Network (EEN), financuar nga Komisioni Europian, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në bashkëpunim me DPPM dhe Qendrën për Promovimin e Konkurrueshmërisë, organizoi, në sallën e Qendrës Rinore Tiranë, seminarin informues, me temë “Rëndësia e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nga Biznesi shqiptar”. Ky seminar organizohet në vazhdim të aktiviteteve që këto institucione kryejnë në shërbim të bizneseve shqiptare dhe për t'i ndërgjegjësuar në lidhje me mbrojtjen e aseteve të tyre në të gjitha fushat ku veprojnë, si për markat tregtare dhe të shërbimit, patentat e shpikjeve, modelet e përdorimit dhe dizenjt industrialë. Në këtë seminar u prezantua informacion mbi legjislacionin e përditësuar të Pronësisë Industriale, aplikimin, procedurat e regjistrimit të objekteve të PI, si dhe institucionet e përfshira në sistem që kryejnë mbrojtjen nga mallrat e falsifikuara.

Seminari i shërbeu bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve publike me biznesin, duke iu afruar kërkesave dhe nevojave të tij, e duke i konsideruar tashmë si bashkëudhëtarë në rrugën e gjatë e të vështirë të sipërmarrjes. Prezantuan znj. Rudina Bollano, Drejtore e ekzaminimit dhe znj. Lindita Meneri, Përgjegjëse e Sektorit të Ekzaminimit të markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.

Seminar në bashkëpunim me Policinë e Shtetit për trajnimin e Oficerëve të Policisë së Krimit Ekonomik, Tiranë.

On 02.06.2016, the Tirana Chamber of Commerce and Industry, in cooperation with the GDPT and the Centre from Promotion of Competitiveness, with the support of the project Enterprise Europe Network (EEN) financed by the European Commission, organised an informational seminar in the hall of the Tirana Youth Centre on the theme “The importance of protecting Intellectual Property by Albanian business.” This seminar was organised in continuation of the activities that those institutions carry out to serve Albanian businesses and to raise awareness in connection with the protection of their assets in all fields where they operate, both for trademarks and service marks, as well as patents of inventions and industrial designs. Information was presented in this seminar about the updated Industrial Property legislation, the application and registration procedures for IP objects, as well as the institutions involved in the system that carry out protection from falsified goods.

The seminar served international cooperation and partnership between public institutions and business, bringing together requests and needs, and already considering themselves as fellow travellers in the long and difficult road of entrepreneurship. Ms. Rudina Bollano, Director of Examination, and Ms. Lindita Meneri, responsible person of the Sector of Examination of Trademarks, Industrial Designs and Geographic Indicators, made presentations.

Seminar in cooperation with the State Police on training Economic Crime Police Officers, Tirana.



Në datat 05-07.09.2016, DPPM mori pjesë në trajnimin e oficerëve të Policisë së Krimit Ekonomik. Ky trajnim u organizua në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda. Tema e seminarit ishte “Mjetet metodat dhe procedurat për hetimin e veprave penale të falsifikimit të kartëmonedhave, dokumenteve, Pronësisë Industriale dhe mashtrimit”. Trajnimi u zhvillua në ambjentet e Akademisë së Policisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga

On 05-07.09.2016, the GDPT took part in training officers of the Economic Crime Police. This training was organised in cooperation with the General Directorate for the Investigation of Organised Crime and Serious Crimes. The theme of the seminar was “Means, methods and procedures for investigating the criminal offences of counterfeiting, fraud and falsification of documents and Industrial Property”. The training was held in the premises of the Police Academy, with the participation of representatives

Drejtoria e Policisë së Shtetit dhe nga Drejtoritë Vendore të Policisë në rrethe si Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, Kukës, Korçë, Dibër dhe përfaqësueset të Akademisë së Policisë. Përfaqësueset e DPPM znj. Lindita Meneri, Përgjegjëse e Sektorit të markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë dhe znj. Rezarta Rajta, Specialiste e koordinimit, promovimit të PI dhe trajnimeve, informuan pjesëmarrësit në lidhje me bazën ligjore të PI dhe i prezantuan me projektligjin e ri për Pronësinë Industriale si dhe me Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intellektuale 2016-2020 dhe me kriteret e regjistrimit të markave tregtare dhe të shërbimit, procedurën e regjistrimit dhe formën e kërkesës për kryerjen e Hetimit në regjistrat e DPPM, kërkimin on-line për marka në bazën e të dhënave në faqen zyrtare të DPPM etj. Oficerët e Policisë sollën për diskutim raste konkrete të shkeljes së të drejtave të PI dhe mënyrën e identifikimit të mallrave të fallsifikuara në treg. Ky seminar i shërbeu mjaft mirë të kuptuarit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të PI.

Seminar me temë Promovimi i EEN, Mbrojtja e Patentave, Markat Tregtare dhe programet financuese të Bashkimit Europian për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme, Tiranë.

from the Directorate of the State Police and the Local Police Directorates in districts such as Tirana, Durrës, Fier, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, Kukës, Korça, Dibër and representatives of the Police Academy. The representatives of the GDPT, Ms. Lindita Meneri, responsible person of the Sector of Trademarks, Industrial Designs and Geographic Indicators, and Ms. Rezarta Rajta, a specialist of the coordination, IP promotion and training, informed the participants about the legal basis for IP and presented the new draft law on Industrial Property as well as the National Strategy for Intellectual Property 2016-2020 and the criteria for registering trademarks and service marks, the procedure of registration and the form of a request to carry out an investigation in the GDPT registers, an on-line search for trademarks on the basis of data on the official web page of the GDPT and so forth. The officers of the police raised several concrete cases of violations of IP rights for discussion and discussed the way to identify falsified goods in the marketplace. This seminar served very well for mutual understanding and cooperation between the institutions in order to assure the protection of IP rights.

Seminar on the theme “Promoting the EEN [the Enterprise Europe Network], protecting patents, trademarks and financial programs of the European Union for SMEs [small and medium enterprises], Tirana



Më datë 30.11.2016, në Hotel International Tirana u organizua një seminar me temë Promovimi i EEN, Mbrojtja e Patentave, Markat Tregtare dhe programet financuese të Bashkimit Europian për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme. Ky aktivitet u organizua si rezultat i bashkëpunimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit me DPPM. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të projektit EEN (Rrjeti Europian i Ndërmarrjeve) si dhe të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim nxitjen e inovacionit dhe ndërgjegjësimin të bizneseve shqiptare mbi rëndësinë e pronësisë industriale.

Në këtë seminar u paraqiten prezantime nga; z. Robert Dumi, Drejtor i Programeve Shumëpalëshe mbi Promovimin e Projektit EEN (Rrjeti Europian i

On 30.11.2016, a seminar was organised in the Hotel International Tirana on the theme “Promoting the EEN, protecting patents, trademarks and financial programs of the European Union for small and medium enterprises (SMEs). This activity was organised as a result of the cooperation of the National Agency of Scientific Research and Innovation and the GDPT. It was conducted in the framework of the activities of the EEN project (Enterprise Europe Network), as well as the strengthening of inter-institutional cooperation for the purpose of encouraging innovation and raising the awareness of Albanian businesses about the importance of Industrial Property.

In this seminar, presentations were made by Mr. Robert Dumi, Director of Multilateral Programs on Promotion

Ndërmarrjeve); z. Ardit Gjipali, Specialist, Programet Shumëpalëshe; z. Besnik Allushi, Specialist në sektorin e ekzaminimit të Patentave DPPM mbi Sistemin i Mbrojtjes së Patentave për Shpikje në Shqipëri; znj. Darian Suli Specialiste në sektorin juridik DPPM mbi Markat tregtare në Shqipëri, procedura e regjistrimit, sistemi ligjor dhe institucionali mbrojtjes së tyre; z. Dhimitraq Mosko, Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë dhe Inovacionit mbi Programet financiare të Bashkimit Europian, H2020 (SME Instrument) Cosme, Innovfin etj. Në këtë seminar pati pjesëmarrje të konsiderueshme nga përfaqësues të biznesit shqiptar të interesuar për sjelljen e inovacionit në veprimtarinë e tyre tregtare. Nga pjesëmarrësit u ngritën shumë pyetje dhe çështje për diskutim mbi temat të cilat u prezantuan. Ky event i hap rrugën një sërë aktiviteteve të ardhshme me qëllim nxitjen e inovacionit.

of the EEN Project, Mr. Ardit Gjipali, a specialist for Multilateral Programs, Mr. Besnik Allushi, a specialist in the Sector of Examination of Patents in the GDPT on the System of Protection of Patents for Inventions in Albania, Ms. Darian Suli a specialist in the legal sector of the GDPT on Trademarks in Albania, procedures of registration, the legal and institutional system of their protection, Mr. Dhimitraq Mosko, responsible person of the Sector of Technology and Innovation on the financial programs of the European Union H2020 (SME Instrument), Cosme, Innovfin and others.

There was considerable representation from Albanian businesses in this seminar, interested to bring innovation into their commercial activity. Many questions and issues for discussion were raised by the participants on the themes were presented. This event opened the way to a series of future activities for the purpose of encouraging innovation.



XIII. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE

Aktualisht Shqipëria është vend anëtar i OBPI dhe ZEP, si dhe ka statusin e vendit vëzhgues me ZBEPI, deri në momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në BE, si dhe ka nënshkruar konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare më të rëndësishme mbi PI. Produkti që del nga këto bashkëpunime është një sistem më i sigurt i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale dhe si rezultat ekonomia e vendit përmirësohet duke krijuar një treg të konsoliduar dhe konkurrencë të ndershme, investime të huaja të shtuara, vlerë e shtuar e kapitalit të kompanive dhe teknologji të reja të implementuara në industrinë e vendit dhe rritje e eksporteve të produkteve vendase.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i DPPM me organizatat ndërkombëtare të Pronësisë Intelktuale OBPI, ZEP dhe ZBEPI ka qenë mjaft intensiv dhe i frytshëm për vitin 2016. Qëllimi i këtij bashkëpunimi konsiston në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në këto organizata si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe përfitimin e asistencës që ato ofrojnë. DPPM mori pjesë rregullisht dhe përfaqësoi Shqipërinë në komitetet e ZEP dhe OBPI në kuadër të plotësimi të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në këto organizata, si dhe në mbledhjet e rëndësishme të ZBEPI si përfaqësues me statusin e vendit vëzhgues. Gjatë këtij viti u koordinua gjithashtu puna mbi pjesëmarrjen dhe trajnimin e stafit të DPPM në seminarët e ofruara nga ZEP, OBPI dhe ZBEPI me qëllim përgatitjen e stafit për të njëjtat standarte të njohjes të sistemit të Pronësisë Industriale.

Gjithashtu takime dhe komunikime të frytshme u kryen nga z. Elvin Lako, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM dhe znj. Elvanda Mece, Drejtore e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve, me drejtues të këtyre organizatave dhe zyra të tjera homologe si:

Takim me z. Antonio Campinos, Drejtor Ekzekutiv i ZBEPI për të diskutuar mënyrat e bashkëpunimit dhe asistencën që ZBEPI mundëson në rritjen e ndërgjegjesimit dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit të pronësisë intelektuale në Shqipëri;

XIII. OPERATIONS AND AGREEMENTS

Currently, Albania is a member country of both WIPO and the EPO, and also has observer status in the EUIPO, until the moment of becoming a member of the EU by the Republic of Albania. It has also signed the most important international agreements and conventions about IP. The product that comes from these agreements of cooperation is a more secure system of protection of Industrial Property rights and as a result the country's economy is improved, creating a consolidated market and fair competition, added foreign investments, added value to the capital of companies and new technologies implemented in local industry and a growth of the exports of local products.

The cooperation and coordination of the GDPT with the international organisations of Intellectual Property. WIPO, EPO and EUIPO, has been quite intensive and beneficial in 2016. The purpose of this cooperation consists in fulfilling the obligations that come from the membership of Albania in those organisations as well as the exchange of experience and the benefiting from the assistance that they offer.

The GDPT took part regularly and represents Albania in EPO and WIPO committees in the framework of meeting the obligations coming from membership in those organisations, as well as in important EUIPO meetings as a representative with observer status. During this year, all the work on participation and training of the staff of the GDPT was coordinated with seminars offered by EPO, WIPO and EUIPO, for the purpose of preparing the staff for the same standards of knowledge of the Industrial Property system

In addition, beneficial communications and meetings were had by Mr. Elvin Lako, Director General of the GDPT, and Ms. Elvanda Meçe, Director of the Directorate of Coordination, IP Promotion and Training with directors of those organisations and other homologous bodies, such as:

Meeting with Mr. Antonio Campinos, Executive Director of EUIPO, to discuss ways of cooperation and assistance that EUIPO makes possible in raising

Takim me z. Michael Svantner Drejtor i Departamentit për Vendet në Zhvillim dhe Vendet e Zhvilluara të OBPI, për të diskutuar mënyrat e mbështetjes së OBPI për implementimin e Strategjisë së Pronësisë Intelektuale 2016-2020;

Takim me z. William Meredith, Drejtor i zyrës së PI për zgjidhjet e Biznesit OBPI, për të diskutuar mënyrat e mundshme të përmirësimeve të shërbimeve rregjistrimit të objekteve të PI on-line për të siguruar një shërbim të shpejtë dhe transparent të aplikanteve;

Takimi me drejtuesit dhe koordinatorët e marrdhënieve me vendet e tjera ZEP për të diskutuar arritjet e deritanishme dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit të mëtejshëm;

Takim me Delegacionin e Republikës Popullore të Kinës, fryt i të cilit ishte dhe firmosja e një Memorandum mirëkuptimi mes SIPO dhe DPPM.

Takim me Delegacionin e Republikës së Polonisë me qëllim formalizimin e diskutimeve paraprake mes drejtuesve të dy zyrave homologe, të cilët shprehën vullnetin e plotë dhe të bazuar në interesin e përbashkët të të dy zyrave për zhvillim të mëtejshëm të PI për të nënshkruar një Memorandum mirëkuptimi;

Takim me Delegacionin Turk të Institutit Turk të Patentave fryt i të cilit ishte dhe firmosja e një Memorandumi mirëkuptimi mes dy zyrave.

Takim me z. Thomas Dillon, Këshilltar në Divizionin e Krijimit të Respektimit të PI, Çështjet Ndërkombëtare OBPI. Në këtë takim u diskutua gjerësisht në nevojën që ka Shqipëria për ndërgjegjësim dhe informim në fushën e PI. Theksi u vendos për nevojën e sjelljes dhe përfshirjes së kurrikulave mësimore në klasat 9-vjeçare dhe të mesme;

Takim me përfaqësues nga Agjensia e Pronësisë Industriale Kosovë. Më 03-04 Gusht 2016 u zhvillua takim me përfaqësues nga Agjensia e Pronësisë Industriale Kosovë dhe DPPM, ku u diskutua për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet dy zyrave, për mirëmbajtjen e sistemit IPAS, Bordin e Apelimit, për menaxhimin e dokumentacionit, për çështjen e procedurës së ekzaminimit të markave tregtare, për procedurën e kundërshtimit dhe shfuqizimit të markave tregtare;

Takim me përfaqësues të ZEP. Në datë 3 qershor 2016 ndërmjet z. Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm DPPM, z. Carlo Pandolfi, Drejtor i Kooperimit Evropian në ZEP, z. David Jelercic, Koordinator me Vendin në ZEP, znj. Elvanda Mece, Drejtore e Koordinimit, Promovimit të PI në DPPM u organizua takim në ambientet e DPPM dhe të Unionit të Dhomave të Tregtisë me qëllim organizimin e Mbledhjes Vjetore mbi Bashkëpunimin e Vendeve Anëtare të ZEP dhe nxitjen e industrisë shqiptare drejt inovacionit.

Takim ndërmjet, z. Donald E. Townsend, Ambasador pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe z. Elvin Lako, Drejtorit të

awareness and improving the functioning of the Intellectual Property system in Albania;

Meeting with Mr. Michael Svantner, Director of the Department for Developing and Developed Countries of WIPO, to discuss ways of WIPO support for the implementation of the Strategy of Intellectual Property 2016-2020;

Meeting with Mr. William Meredith, director of the WIPO IP office for business solutions, to discuss possible ways of improving services of the registration of IP objects on-line to assure a rapid and transparent service for applicants;

Meeting with the directors and coordinators of coordination with other EPO countries to discuss achievements to date and the continuation of further cooperation;

Meeting with the Delegation of the People's Republic of China, one result of which was the signing of a Memorandum of Understanding between SIPO and the GDPT.

Meeting with the Delegation of the Republic of Poland for the purpose of formalising preliminary discussions between the directors of the two homologous offices, which express their full and grounded will in the joint interest of the two offices for further development of IP to sign a Memorandum of Understanding.

Meeting with the Delegation of the Turkish Patent Institute, one result of which was the signing of a Memorandum of Understanding between the two offices.

Meeting with Mr. Thomas Dillon, Adviser in the Division of Creation of Respect for IP, International Issues, WIPO. In this meeting, the need Albania has for awareness and information in the IP field was discussed. Emphasis was placed on the need for conduct and inclusion in teaching curricula for elementary and secondary classes.

Meeting with representatives from the Kosova Agency of Industrial Property. On 03-04 August 2016, a meeting was held with representatives from the Kosova Agency of Industrial Property and the GDPT, where discussion centered on further cooperation between the two offices for maintenance of the IPAS system. the Board of Appeal, management of documentation, the issue of the procedure of examination of trademarks, and the procedure for opposition and cancellation of trademarks;

Meeting with representatives of the EPO. On 3 June 2016, a meeting was held in the GDPT premises between Mr. Elvin Lako, Director General of the GDPT, Mr. Carlo Pandolfi, Director of European Cooperation in EPO, Mr. David Jelercic, Country Coordinator in the EPO, Ms. Elvanda Meçe, Director of Coordination, IP Promotion and Training in the GDPT, for the purpose of organising the Annual Meeting on Cooperation of the Member States of EPO and encouraging Albanian industry towards innovation.

Përgjithshëm i DPPM. Takimi i zhvillua me datë 10.10.2016, pranë ambienteve të DPPM. Atasheu i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Moskë, mbulon çështjet mbi Rusinë, Shtetet e Pavarura të Komunuelthit dhe Gjeorgjisë, z.Donald E. Townsend, Jr. Përveç këtij portofoli vendesh, z. Donald E. Townsend, Jr, është edhe person kontakti për çështjet e të drejtave të PI edhe për vendet e Evropës lindore dhe Shqipërinë. Gjatë këtij takimi, u diskutuan çështje në lidhje me mundësitë e frytshme të bashkëpunimit në vijim, për të lidhur marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet institucioneve tona, në shkëmbime eksperiencash në fushën e PI si dhe mbështetjen që SHBA ofrojnë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend. DPPM, në mënyrë të vazhdueshme shkëmben raporte dhe dokumente kryesore strategjike të Pronësisë Industriale duke u konsultuar me Ambasadën e SHBA, si një mbështetës i rëndësishëm për çështjet e Pronësisë Industriale.

Gjithashtu koordinimi dhe bisedimet e kryera me përfaqësuesit e organizatave dhe zyra homologe të vendeve të tjera mbi PI, sollën si rezultat lidhjen e Memorandumeve të mirëkuptimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e standarteve të njëjta ose të përafërta të mbrojtjes së sistemit të PI në rrafsh rajonal dhe më gjerë.

Më poshtë një përshkrim i Memorandumeve të mirëkuptimit të lidhura nga DPPM në vitin 2016:

Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Botërore të Pronësisë Industriale -datë, 04.03.2016

Ky memorandum u nënshkrua me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit mbi mbrojtjen e PI, nxitjen e aktiviteteve në fushën e PI dhe mbështetjen e qëllimeve të përbashkëta në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të PI. Bashkëpunimi do të konsistojë në kërkime, mësimdhënie dhe në ndërtimin e kapacitetit të burimeve njerëzore në fushën e mbrojtjes së PI në Shqipëri. Nëpërmjet bashkëpunimit me DPPM që synon në përmirësimin e administrimit të zyrës, zhvillimin e burimeve njerëzore për ekzaminimin e patentave dhe markave dhe mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të PI, në mënyrë që të nxitet ndërgjegjësimi më i madh mbi PI dhe ndërtimi i kapaciteteve për të drejtuar zhvillimin e profesionistëve të aftë të PI për të mbështetur komunitetet e kërimit dhe të biznesit, për të ofruar një gamë të gjerë dhe multi disiplinare të mundësive të vazhdueshme të edukimit dhe trajnimit për profesionistët e PI, si: Organizatat e biznesit, institucionet e kërimit, stafin e DPPM dhe krijuesit dhe përdoruesit e tjerë të PI. OBPI do të asistojë DPPM në zhvillimin e infrastrukturës, kryesisht në hartimin e programeve të trajnimit, sigurimin e platformave për të mësuar në distancë dhe organizimin e kurseve të përbashkëta. Palët nëpërmjet një procesi konsultimi me aktorë të sistemit të PI do të bashkëpunojnë në formulimin e një strategjie kombëtare mbi PI

Meeting between Mr. Donald E. Townsend, Attaché at the Embassy of the United States of America and Mr. Elvin Lako, Director General at the GDPT. The meeting was held on 10.10.2016, at the premises of the GDPT. The Attaché of the Embassy of the USA in Moscow, covers issues about Russian, the Independent States of the Community and Georgia, and in addition to this portfolio of country, Mr. Townsend is also the contact person for IP issues for the countries of Eastern Europe, including Albania.

During this meeting, issues were discussed in connection with beneficial possibilities of on-going cooperation, to enter into an agreement of understanding between our institutions, the exchange of experiences in the IP field and as well as support offered by the USA for improving the business climate in the country. The GDPT continuously exchanges reports and main strategic documents of Industrial property, consulting with the Embassy of the USA, as an important supporter on issues of Industrial Property.

In addition, discussion on coordination held with representatives of homologous offices and organisations of other countries about IP brought as a result the entering into of memoranda of understanding for the purpose of exchanging experiences and creating standards that are the same or approximately the same for protection of the IP system on the regional plane and more broadly.

Below, a description of Memoranda of Understanding entered into by the GDPT in 2016:

Memorandum of Understanding with the World Intellectual Property Organisation, 04.03.2016

This memorandum was signed for the purpose of developing cooperation on IP protection, encouraging activities in the IP field and supporting mutual purposes in connection with the further development of IP. The cooperation will consist of research, teaching and capacity building of human resources in the field of protection of IP in Albania.

Through cooperation with the GDPT, which aims at improving the administration of the office, the development of human resources for the examination of patents and marks and the protection and strengthening of IP rights, in such a manner as to draw out greater awareness about IP and build capacities to lead the development of capable IP professionals supported on communities of research and business, in order to offer a broad and multi-disciplinary range of continuous possibilities for the education and training of IP professionals, such as business organisations, research institutions, the staff of the GDPT and creators and other IP users. WIPO will assist the GDPT in the development of infrastructure, mainly in drawing up training programmes, securing platforms for distance learning and organising joint course.

Through a process of consultation with IP system actors, the parties will cooperate in formulating a

për Shqipërinë, për të përdorur në mënyrë efektive sistemin e PI për përmbushjen e qëllimeve të zhvillimit kombëtar. Palët, së bashku, do të marrin në konsideratë organizimin e simpoziumeve, seminareve takimeve dhe programeve të tjera të trajnimit në Shqipëri, si dhe të do të bashkëpunojnë në zhvillimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të PI në Shqipëri dhe në zhvillimin e aktiviteteve në lidhje me promovimin e inovacionit në Shqipëri.

Rinovim i Memorandumit të Mirëkuptimit me Institutin Turk të Patentave.

national IP strategy for Albania, to use the IP system effectively for meeting the purposes of national development. The parties together will take into consideration the organisation of symposia, seminars, meetings and other training programmes in Albania and will also cooperate in the development of the legal framework for protection of IP rights in Albania and the development of activities in connection with promoting innovation in Albania.

Renewal of Memorandum of Understanding with the Turkish Patent Institute



Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe Institutit Turk të Patentave (TPI) u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPM z.Elvin Lako dhe Presidenti i Insitutit Turk të Patentave z.Habip Asan. Ishin të pranishëm edhe znj. Elvanda Meçe, Drejtore e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve në DPPM dhe Z. Kadri Yavuz Özbay, Përgjegjës i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Insitutit Turk të Patentave.

The Memorandum of Understanding between the General Directorate of Patents and Marks (GDPT) and the Turkish Patent Institute (TPI) was signed by the Director General of the GDPT, >r. Elvin Lako, and the President of the Turkish Patent Institute, Mr. Habip Asan. Ms. Elvanda Meçe, Director of the Directorate of Coordination, IP Promotion and Training in the GDPT and Mr. Kadri Yavuz Özbay, responsible person of the Office of International Relations of the Turkish Patent Institute, were also present.

Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, është formalizim i diskutimeve paraprake mes drejtuesve të dy zyrave homologe, të cilët shprehën vullnetin e plotë dhe të bazuar në interesin e përbashkët të të dy zyrave për zhvillim të mëtejshëm të PI. Bashkëpunimi në këtë fushë mes dy zyrave homologe, daton që prej 18-20 qershorit të vitit 2009, me nënshkrimin e marrëveshjes së parë, për një periudhë 5-vjeçare në Ankara të Turqisë.

The signing of this Memorandum of Understanding was the formalisation of preliminary discussions between the directors of the two homologue offices, who expressed their full will, based on the mutual interest of the two offices for the further development of IP. Cooperation in this field between the two homologue offices dates from 18-20 June of the year 2009, with the signing of the first agreement in Ankara, Turkey, for a five-year period.

Ky memorandum nënshkruhet dhe rinovohet duke konsideruar rëndësinë e Pronësisë Industriale për zhvillimin e ekonomisë, nxitjen e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë, si dhe për të forcuar sistemet kombëtare të PI me qëllim garantimin e administrimit të duhur të PI. Nevoja dikton domosdoshmëri për bashkëpunim më të gjerë bilateral ndërmjet zyrave homologe, duke forcuar sistemet e Pronësisë Industriale ekzistuese dhe duke krijuar një mekanizëm për shkëmbim të rregullt të informacionit

This memorandum was signed and renewed taking into consideration the importance of Industrial Property for the development of the economy, the encouragement of innovation and the exchange of technology, as well as to strengthen the national IP systems, for the purpose of guaranteeing appropriate IP administration. The need made it essential for broader bilateral cooperation between the homologous offices, strengthening the existing Industrial Property systems and creating a mechanism for the regular

dhe të praktikave më të mira, si dhe për të ndërmarrë së bashku trajnime dhe aktivitete të përbashkëta duke nxitur në këtë mënyrë, bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.

Memorandumi i Mirëkuptimit me Zyrën Shtetërore të Pronësisë Intelektuale të Republikës Popullore të Kinës.



Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe Zyrës Shtetërore të Pronësisë Intelektuale të Republikës Popullore të Kinës u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, z. Elvin Lako dhe Komisionerit të Zyrës Shtetërore të Pronësisë Intelektuale të Republikës Popullore të Kinës z. Shen Changyu. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: z. Wu Kai, Drejtor Përgjithshëm, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar, z. Zhao Zhibin, zv. Drejtor Përgjithshëm, Zyra e Çështjeve të Përgjithshme, znj. Wang Ying, Drejtore, Divizioni IV, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar, z. Han Guoqing, zv. Drejtor, Sekretariati, Zyra e Çështjeve të Përgjithshme, z. Zhang Keyi, Administrator Projekti, Divizioni I, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

Drejtuesit e të dy zyrave homologe shprehën vullnetin e plotë dhe të bazuar në interesin e përbashkët të të dy zyrave për zhvillim të mëtejshëm të Pronësisë Industriale. Bashkëpunimi në këtë fushë mes dy zyrave homologe, është i një rëndësie të veçantë, pasi Zyra Shtetërore e Pronësisë Intelektuale të Republikës Popullore të Kinës, është një ndër institucionet më të rëndësishme në fushën e PI në botë. Ky memorandum nënshkruhet duke konsideruar rëndësinë e PI për zhvillimin e ekonomisë, nxitjen e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë, duke njohur nevojën për të promovuar dhe përmirësuar inovacionin, si dhe për të forcuar sistemet kombëtare të Pronësisë Industriale me qëllim garantimin e administrimit të duhur, mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të PI.

Bashkëpunimi më i gjerë bilateral ndërmjet Zyrave homologe është domosdoshmëri, pasi forcohen

exchange of information and best practices, as well as to undertake together training and joint activities, in this way encouraging further cooperation between the Republic of Albania and the Republic of Turkey.

Memorandum of Understanding with the State Office of Intellectual Property of the People's Republic of China

The Memorandum of Understanding between the General Directorate of Patents and Marks (GDPT) and the State Office of Intellectual Property of the People's Republic of China was signed by the Director General of the GDPT, Mr. Elvin Lako, and the Commissioner of the State Office of Intellectual Property of the People's Republic of China, Mr. Shen Changyu. Also present were Mr. Wu Kai, Director General, Department of International Cooperation, Mr. Zhao Zhibin, deputy Director General, Office of General Issues, Ms. Wang Ying, Director, Division IV, Department of International Cooperation, Mr. Han Guoqing, deputy Director, Secretariat, Office of General Issues, Mr. Zhang Keyi, Project Administrator, Division I, Department of International Cooperation.

The directors of the two homologue offices expressed their full will, based on the mutual interest of the two offices for the further development of Industrial Property. Cooperation in this field between the two homologue offices is of special importance, because the State Office of Intellectual Property of the People's Republic of China is one of the most important institutions in the IP field in the world. This memorandum was signed taking into account the importance of IP for the development of the economy, the encouraging of innovation and the exchange of technology, recognising the need to promote and improve innovation, as well as to strengthen the national systems of Industrial Property for the purpose of guaranteeing the appropriate administration, protection and use of IP rights.

Broader bilateral cooperation between homologous offices is essential, because it also strengthens IP

sistemet e PI dhe krijohet një mekanizëm për shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira. Së bashku do të kryhen trajnime dhe aktivitete të përbashkëta duke nxitur në këtë mënyrë bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, me qëllim zhvillimet ekonomike dhe teknologjike.

Memorandum i Mirëkuptimit me Zyrën e Patentave të Polonisë – 04.10.2016

Ky Memorandum, u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, z. Elvin Lako dhe Presidentes të Zyrës së Patentave të Polonisë znj. Alicia Adamczak. Drejtuesit e të dy zyrave homologe shprehën vullnetin e plotë për bashkëpunimin reciprok të të dy zyrave për zhvillim të mëtejshëm të PI. Bashkëpunimi në këtë fushë mes dy zyrave homologe, është i një rëndësie të veçantë, pasi mbrojtja e të drejtave të Pronësisë Industriale është më e garantuar kur krijohen standarde të njëjta mbrojtje në rrafsh ndërkombëtar. Gjatë diskutimeve paraprake u diskutua mbi rëndësinë e PI për zhvillimin e ekonomisë, nxitjen e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë, duke njohur nevojën për të promovuar dhe përmirësuar inovacionin, si dhe për të forcuar sistemet kombëtare të PI me qëllim garantimin e administrimit të duhur, mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të PI. Në sajë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të jetë i mundur bashkëpunimi i ndërsjellë, duke i shërbyer forcimit të sistemeve respektive të Pronësisë Industriale nëpërmjet mekanizmave për shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira, si dhe për të ndërmarrë së bashku trajnime dhe aktivitete të përbashkëta duke nxitur në këtë mënyrë bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Polonisë.

Bashkëpunime ndërinstytucionale Vendase.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shqiptare të përfshira në sistemin e PI dhe zbatimi i planit të veprimit të parashikuar në Strategjinë Kombëtare të PI 2016-2020 përbën një rëndësi të veçantë për aktivitetin e DPPM.

Për këtë arsye u koordinua puna me MZHETTS dhe institucionet e tjera vendase. Vazhdimisht DPPM ka bashkëpunuar dhe u ka adresuar ministrive përkatëse kërkesa institucionale për t'u përfshirë në strategjitë kombëtare për zhvillimin e inovacionit në Shqipëri si p.sh. në "Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë e Inovacionin 2017-2022" dhe koordinimin e saj me "Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intellektuale 2016-2020", si dhe u përgatit inkorporimi i rolit të DPPM në Planin e Veprimit 2016-2020 "Mbështetje për Hartimin e Politikave Inovative Bazuar në Qasjen *Triple Helix*", duke konsideruar që mbrojtja e PI është nxitësi kryesor i punës krijuese dhe inovacionit. Bashkëpunimi ndërinstytucional konsiderohet të jetë çelësi i suksesit dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të PI në Shqipëri.

systems and creates a mechanism for the regular exchange of information and best practices. Together, trainings and joint activities will be held, in this way encouraging further cooperation between the Republic of Albania and the People's Republic of China, for the purpose of economic and technological development.

Memorandum of Understanding with the Patent Office of Poland – 04.10.2016

This Memorandum was signed by the Director General of the GDPT, Mr. Elvin Lako and the President of the Patent Office of Poland, Ms. Alicia Adamczak. The directors of the homologue offices expressed their full will for reciprocal cooperation of the two offices for the further development of IP. Cooperation in this field between the two offices is of special importance, because protection of Industrial Property rights is better guaranteed when the same standards of protection are created on the international plane.

During the preliminary negotiations, there was a discussion of the importance of IP for the development of the economy, the encouragement of innovation and the exchange of technology, as well as for strengthening the national IP systems for the purpose of guaranteeing the appropriate administration, protection and use of IP rights. Thanks to this Memorandum of Understanding, mutual cooperation will be possible, serving to strengthen the respective systems of Industrial Property through mechanisms for the regular exchange of information and best practices, as well as to undertake joint trainings and mutual activities, thus encouraging further cooperation between the Republic of Albania and the Republic of Poland.

Local inter-institutional cooperation

Cooperation among the Albanian institutions involved in the IP system and implementation of the action plan provided in the National IP Strategy 2016-2020 has special importance for the activity of the GDPT.

For this reason, work was coordinated with MEDTTE and the other Albanian institutions. The GDPT has constantly cooperated with and addressed institutional requests to the respective ministers so that they will be involved in the national strategy for the development of innovation in Albania, such as, for example, the "National Strategy for Scientific Research, Technology and Innovation 2017-2022" and its coordination with the "National Strategy for Intellectual Property 2016-2020", and the role of the GDPT was also incorporated in the Action Plan 2016-2020 "Support for drawing up innovative policies based on the *Triple Helix* approach", considering that IP protection is the main incentive of creative work and innovation. Inter-institutional cooperation is considered to be the key to success and to guarantee protection of IP rights in Albania.

Në vitin 2016 DPPM ka qenë gjithashtu mjaft aktive duke organizuar takime ndërinstucionale me qëllim ngritjen e urave të bashkëpunimit për evidentimin e personave dhe subjekteve me potencial për krijues dhe orientimin e tyre drejt zyrave të DPPM për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të PI.

Disa nga takimet e organizuara janë:

- Takim mes drejtuesve të DPPM dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - datë 02/09/2016

In 2016, the GDPT was also quite active in organising inter-institutional meetings for the purpose of building bridges of cooperation to identify persons and subjects with creative potential and orienting them to the offices of the GDPT for registration and protection of IP objects.

Several of the meetings organised were:

- Meeting among the directors of the GDPT and the Academy of Sciences of Albania, 02.09.2016



Takimi u zhvillua në ambjentet e Akademisë së Shkencave me pjesëmarrjen e drejtuesve të DPPM dhe Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASH). Ky takim u iniciua me kërkesë të DPPM duke parashtruar nevojën për bashkëpunimin mes dy institucioneve me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga “Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intellektuale 2016-2020”, e cila parashikon si prioritet të saj nxitjen dhe zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë në Shqipëri. Ky zhvillim do të arrihet nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërinstucional. Drejtuesit e Akademisë së Shkencave u treguan mjaft të gatshëm për të pritur dhe dëgjuar propozimet për bashkëveprim në këtë fushë bazuar në interesin e përbashkët të të dy institucioneve për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë në vendin tonë. Gjatë takimit, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, z. Elvin LAKO theksoi që vlera e shpikjes dhe krijimi i tregut të shit-blerjes së patentës fitohet vetëm me anë të rregjistrimit pranë DPPM. Një treg i suksesshëm mund të ngrihet bazuar në nevojat reciproke që biznesi ka për shkencën dhe shkenca ka nevojë të paguhet nga biznesi.

Gjithashtu Drejtori i Përgjithshëm, z. Elvin Lako paraqiti një panoramë të sistemit të Pronësisë Industriale në Shqipëri si dhe pikat strategjike ku mund të konsistojë bashkëpunimi ndërinstucional si:

